

The logo for the Assembly Supportive Newsletter, consisting of the letters 'ASJ' in a stylized, blue, serif font.


A s s e m b l y S u p p o

Newsletter

Korrik 2003, No 06

The logo for the OSCE Mission in Kosovo, featuring the acronym 'OSCE' in a blue box above the text 'Mission in Kosovo'.

t i v e

- 
- A black and white photograph of Prof. Dacin, the Chairman of the Kosovo Assembly, sitting in a chair and smiling. He is wearing a dark suit, a white shirt, and a patterned tie. The background is dark and out of focus.
- Intervista me prof. Dacin,
Kryetar i Kuvendit të Kosovës
 - Mesazhi nga Zyra e SHBA-ve
 - Vizitë pune e Komisioneve të Kuvendit

Nga redaktori

Fundi i vitit parlamentar dhe pushimet verore po afrohen. Për këtë arsye ne i kemi lutur tre anëtarë të Kryesisë së Kuvendit - përfshirë këtu edhe kryetarin e Kuvendit z.Dacin - që të japin një vlerësim rreth asaj se çfarë është arritur këtë vit. Me këtë rast ambasadori Harnish nga Zyra Amerikane, pranoi me kënaqësi që të japë vlerësimin e tij. Njëherësh edhe z. Simon Hejzlok në emër të UNMIK-ut si dhe organizata joqeveritare e Kosovës KMDLNJ dhanë kontributin e tyre në këtë drejtim. Veç kësaj, në këtë numër janë përfshirë edhe kontributet e parlamentarëve nga vendet e ndryshme të botës rreth vizitave të tyre në Kosovë.

Ky buletin i ri informativ ASI sjell informacione për dy muajt e fundit të punës së Kuvendit. Në këtë numër ju poashtu do të gjeni informacione mbi punën legjislative të Kuvendit, debatet politike dhe aktivitetet e ndryshme për përkrahjen e Kuvendit. Meqë Kuvendi ka arritur të konsolidohet më mirë gjatë këtij viti, atëhere edhe politikat dhe planet rreth përkrahjes së aktiviteteve të Kuvendit janë përcaktuar më qartë, në veçanti ato që ndihmojnë komisionet të cilat merren me draft ligje të ndryshme.

Shpesh, puna legjislative ishte e cilësisë së lartë. Derisa, nga njëra anë, janë miratuar një sërë ligjesh ekonomike dhe bujqësore, nga ana tjetër, nevoja për legjislacion social po rritet vazhdimisht. Siç vuiri në dukje edhe z. Daci në intervistën e tij, potenciali për trazira shoqërore është në rritje. Në të njëjtën kohë, çështje të tjera me rëndësi jashtëzakonisht të madhe po i formësojnë dhe konkretizojnë debatet politike: prezenca e Kosovës në takimet ndërkombëtare dhe dialogu me të gjithë fqinjët, duke përfshirë këtu edhe Beogradin.

Nëse i hedhim një vështrim të shpejtë skenës politike të 12 muajve të fundit, mund të thuhet dhe të konstatohet se Kuvendi i Kosovës është shndërruar në një qendër të mirëfillët të debatit politik në Kosovë. Kështu edhe duhet të jetë në demokracinë që funksion.

Franklin De Vrieze,
OSBE Departamenti i Demokratizimit
Kordinator i ASI-t

Predsedništvo Skupštine Kosova

Nexhat Daci,
Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK),
Kryetar i Kuvendit

Fatmir Sejdiu,
Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Hydajet Hyseni,
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

Xhavit Haliti
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

Oliver Ivanoviq,
Koalicioni Kthimi (KP)

Gojko Saviq,
Koalicioni Kthimi (KP)

Nafiye Gas,
Komunitetet Tjera

Bajram Kosumi,
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)



Koha për ide të reja në Kosovë

Me ftesën e Fondacionit Friedrich Naumann dhe ASI-it, në fund të muajit maj të vitit 2003, Mr. Rainer Stinner vizitoi Kosovën. Si anëtar i Bundestag-ut gjerman, ai u takua me homologët e tij nga Komisioni për Buxhet, Komisioni për Tregëti dhe Industri, Komisioni për Ekonomi dhe Financa, si dhe nga disa ministri të qeverisë, me zyrtarë të Bashkësisë Evropiane, dhe me PSSP Z. Steiner.

Më poshtë janë paraqitur konkluzionet dhe sugjerimet e tij.

Rainer Stinner, anëtarë i Bundestag-ut gjerman

Dy gjëra mund të vërehen qartë në Kosovë: nga njëra anë një numër i shtëpive të reja dëshmojnë efektshmërinë e ndihmës ndërkombëtare, por nga ana tjetër numri i madh i mbikëqyrësve dhe këshilltarëve ndërkombëtarë është aq mahnitës, sa që të bën të dyshosh nëse bartja e kompetencave tek instancat vendore në Kosovë ka pasur ndonjë sukses deri më tash.

Gjatë muajve të fundit, numri i kundërshtive midis UNMIK-ut dhe autoriteteve vendore është shtuar dukshëm. Edhe sa do të mbizotërojë përsëritja mekanike e "standardeve para statusit"? Politikanët në Kosovë, mbikëqyrësit ndërkombëtarë dhe shumë politikanë të Beogradit e dinë se duhet të gjinden mënyra dhe zgjidhje të reja për çështjen e statusit të Kosovës. Marrëdhëniet e afërta apo ndoshta edhe anëtarësimi në BE, duket se është cak përfundimtar i shumë politikanëve.

Shumica e evropianëve të Evropës Perëndimore mendojnë se gjendja në Evropën Juglindore është fashitur

pas përfundimit të luftës së hapur dhe se tani mbizotëron paqja në rajon. Kjo paqë është shumë e brishtë, meqë shumë probleme urgjente ende nuk janë zgjidhur. Do thënë se problemet janë shumë të ngjashme në tërë rajonin. Në një situatë të tillë, për Evropën është më së miri që të luajë një rol më aktiv në rajon. Nuk ka dyshim se ky rajon është pjesë e zemrës së Evropës dhe se i përket asaj. Evropa tanimë është duke investuar shuma të mëdha parash për ta zhvilluar rajonin dhe për të përmirësuar standardet, në mënyrë që në të ardhmen t'i vëjë ato në vijë me Bashkësinë Evropiane. Në anën tjetër, duhet të bëhet e qartë se nuk është në interes të BE-së apo të qytetarëve të saj që t'i ftojnë vendet me ekonomi dhe shoqëri jostabile, të cilat ende nuk i kanë zgjidhur problemet e tyre rajonale dhe etnike, që t'u bashkangjiten vendeve anëtare. Evropa duhet të jetë bashkësi e fqinjëve të mirë dhe duhet t'i ftojë për anëtarësim vetëm fqinjët e mirë.

Situata ekonomike në Kosovë është çështja më me rëndësi. Deri më tash, nuk mund të vërehet ndonjë indikator i ndonjë ringjalljeje të qëndrueshme të ekonomisë në Kosovë. Numri i madh i shtëpive të reja në Kosovë, duket si një shenjë e mirë dhe impresionuese, por kjo vetëm dëshmon se kapitali shpenzohet në konsum. Një pjesë e madhe e këtij kapitali shpenzohet në import, meqë pjesa më e madhe e materialit ndërtimor vjen nga shtetet e jashtëme. Shihet qartë mungesa e një investimi produktiv. Që ta josh këtë kapital të jashtëm, Kosova duhet të dëshmojë se ka besim në vetvete. Një indikator i mundshëm për këtë mund të jetë rialokimi i kapitalit nga konsumimi në investim. Kjo nuk mund të jetë detyrë vetëm e bashkësisë ndërkombëtare. Autoritetet e Kosovës duhet të zbatojnë një politikë ekonomike që mbështet krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Mund të vihet në dyshim vënja e tatimeve të larta për import, sepse kjo nënkupton vënjen e tatimeve madje edhe para se ndërmarrjet të arrijnë



të jenë produktive gjë që pakëson burimet e pakta të kapitalit qysh në fillim të ciklit të prodhimit. Vënja e një sistemi funksional dhe efikas bankar paraqet prioritet të lartë për zhvillimin ekonomik. Në situatë të tillë, lypset të shqyrtohet roli dhe numri i këshilltarëve dhe mbikëqyrësve ndërkombëtarë. Nga jashtë duket qesharake kur Kuvendi i Kosovës miraton ligje që shkruhen me ndihmën e këshilltarëve ndërkombëtarë, ndërsa të njëjtat ligje hidhen poshtë nga UNMIK-u.

BE-ja mund të luajë një rol më aktiv në përmirësimin e kësaj gjendjeje. Në këtë

mënyrë, Kosova mund të bëhet shembull i aftësisë politike të Evropës për t'i zgjidhur problemet e brendshme. Ide apo simbol për një shembull të tillë mund të jetë transferimi nga UNMIK në "EUMIK", çfarë nënkupton se BE nuk do të paraqiste vetëm një rën prej shtyllave të OKB-së, por do ta mbante përgjegjësinë për tërë procesin. Pastaj, mund të shqyrtohet edhe mundësia e angazhimit të një trupe ushtarake evropiane në vend të KFOR-it, siç është vepruar edhe në Maqedoni në një shkallë më të ulët. Meqë pothuaj të gjitha grupet dhe partitë politike në rajon shpresojnë dhe aspirojnë anëtarësimin në BE, BE-ja duhet t'ia rrëfejë rajonit rrugën drejt integritimit në Evropë. Kjo perspektivë afatgjate duhet të ndihmojë edhe në zgjidhjen e problemeve të vazhdueshme etnike dhe rajonale.

Është koha për ide të reja në Kosovë. Emërimi i një përfaqësuesi të ri special të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, duhet të përdoret në mënyrë inteligjente si pikënisje për një fazë të re të zhvillimit të Kosovës.

“Na duhet një hartë orientuese që do t’na ndihmonte t’i realizojmë synimet tona.”

Intervistë me Prof. Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit të Kosovës

Intervistuar nga Sven Lindholm dhe Franklin De Vrieze.

Në fund të këtij viti parlamentar, çfarë mendoni se kanë qenë sukseset që keni arritur dhe sfidat me të cilat jeni ballafaquar?

Duhet ta pranoj se nuk ka qenë e lehtë, posaçërisht në fillim. E kemi pasur vështirë që t’i bashkojmë partitë dhe grupet e ndryshme etnike. Por, sidoqoftë, këto probleme i kemi tejkaluar. Sa i përket Kryesisë së Kuvendit, anëtarët e saj kanë qenë kooperativë dhe shumë të hapur për t’i diskutuar të gjitha problemet. Madje mendoj se mund t’ia dërgojë komplimentet e mia Koalicionit Kthimi (KP).

Si do ta vlerësonit punën e Kryesisë në udhëheqjen e punës së Kuvendit gjatë shqyrtimit të çështjeve të ndryshme legjislative?

Mendoj se Kryesia ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë. Nganjëherë iniciativat e propozuara nga deputetët e Kuvendit nuk ishin edhe aq përmbajtësore, por Kryesia ua ka dhënë trajtën dhe e ka zëjatur praninë e tyre në agjendë për t’i diskutuar më tutje. Në ndërkohë, diskutimet miqësore kanë rezultuar me një punë të mirë gjatë seancave plenare.



Gjatë vitit të fundit Kuvendi është ballafaquar me sfida organizative dhe politike. Përdërisa sfidat praktike dhe organizative janë tejkaluar, kanë mbetur ende shumë sfida politike me të cilat duhet ballafaquar: bojkotet e njëjërës seancë apo tjetrën nga ana e KP-së, PDK-së dhe AAK-së. Si i trajtoni ju si Kryetar i Kuvendit këto konflikte politike?

Sa u përket çështjeve teknike, keni të drejtë, Kuvendi po e kryen punën e vet. Sa u përket problemeve politike, Kuvendi ka filluar t’i trajtojë ato në mënyrë demokratike. PDK-ja vjen e shkon. Çështja e Koalicionit Kthimi është paksa problematike, meqë ata asnjëherë nuk kanë dhënë ndonjë propozim konkret

për përmirësimin e jetës së serbëve në Kosovë. Ata vetëm janë larguar nga seancat plenare, duke thënë se projektligjet nuk kanë qenë kompatibile me ligjet e Beogradit. Në Kryesi ne përpiqemi që të shpjegojmë se jemi nën protektoratin e BE-së dhe se sipas Kornizës Kushtetuese nuk jemi të obliguar ta marrim parasysh një ankesë të tillë. Por, mendoj se duhet të bëjmë më shumë që t’i ndihmojmë Koalicionit Kthimi që të punojë me ne në Kuvend. Ka shenja pozitive. Gjatë bisedave private ata janë të gatshëm të bisedojnë lidhur me problemet. Kjo më kënaq, sepse unë dhe Kryesia jemi mjaft të hapur ndaj çdo çështjeje që ka të bëjë me qytetarët e Kosovës.

Vitin e ardhshëm do të mbahen zgjedhjet dhe ka gjasa do jeni prezent gjatë zhvillimit të shumë debatteve politike në Kuvend. Çfarë debate mund të zhvillohen dhe si do merret Kryesia me to?

Katër vite pas çlirimit, priten disa ndryshime në reagimet e grupeve të ndryshme parlamentare dhe etnike. Mendoj se minoritetet do të ngrejë shumë

çështje në Kuvend, ndërsa ne jemi të gatshëm që t’i dëgjim me kujdes. KP-ja me gjasë do të përpiqet të nxitë më shumë diskutime mbi ruajtjen e lidhjeve me Serbinë, por edhe mbi problemet e vërteta të jetës në Kosovë. Mendoj se minoritetet dhe grupet e vogla politike shqiptare do të kërkojnë më shumë vend në institucione - çfarë është normale në një vend demokratik. Duhet ta gjejmë një zgjidhje që do t’i kënaq madje edhe partitë më të mëdha politike. LDK-ja është dëmtuar mjaft në zgjedhjet e para kombëtare, por situata politike e kërkoi këtë përmes votës. Mendoj se është vepruar mirë që u është dhënë më shumë hapësirë grupeve më të vogla politike, meqë u është dhënë mundësia që të jenë së bashku dhe të diskutojnë mbi problemet e përgjithshme.

Çfarë mund të na thoni lidhur me debatet midis tri partive kryesore shqiptare të Kosovës - LDK-së, PDK-së dhe AAK-së - meqë ato garojnë për vota?

Nëse bashkësia ndërkombëtare insiston në votimin përmes listave të mbyllyra, nga njëra anë, kjo do t’u

jap më shumë fuqi liderëve të partive politike, por, në anën tjetër, do ta dëmtojë procesin demokratik. Sot, deputetët e Kuvendit janë më shumë të lidhur me liderët e partive të tyre se me punën normale në Kuvend. Nuk kemi elektorat; deputetët nuk i shkëmbejnë informatat me zgjedhësit e tyre. Liderët politikë janë jashtëzakonisht të fortë dhe kjo nuk është shenjë e mirë për demokracinë. Në diskutimet që janë duke u zhvilluar, PDK-ja dhe AAK-ja janë duke insistuar në listat e hapura. LDK-ja hezitoi të marrë një vendim të tillë. Por, nuk mund të thoni, “do ta marrë një pjesë të demokracisë, ndërsa pjesën që s’më pëlqen, nuk e dua.” Gjithashtu, Kryetari i Kosovës duhet të zgjedhet drejtpërsëdrejti, përmes votimit të hapur. Duhet t’i vërejmë anët pozitive dhe negative të një procesi të tillë dhe disi t’i kombinojmë ato për ta gjetur zgjidhjen më të mirë për Kosovën.

Tani kalojmë në një temë delikate, transferimi i kompetencave. KB thonë se akoma më tepër do të transferohet, derisa ju dhe Kuvendi thoni se u është dhënë jo aq shumë, dhe

se duart e juaja janë të lidhura. Atëherë, si do të ndikoj kjo në punën e Kuvendit?

Nëse dëshirojmë të jemi analitikisht dhe politikisht korrekt dhe të sigurtë, duhet të themi se të dy palet, PISG dhe UNMIK-u, kanë bërë gabime shumë të mëdha. Një pjesë e obligimeve dhe e përgjegjësive, sipas kornizës kushtetuese, është dashur të transferohen që në fillimin e punës së PISG. Por asgjë nuk ndodhi për një vit. Çfarë ishte gabimi ynë? Ne nuk e kemi gjetur rrugën e drejtë të marrim këto përgjegjësi, sigurisht pse ne nuk kemi mundur të gjejmë mënyrën për një bashkëpunim më të mirë me UNMIK-un. Dobësia jone e dytë ishte: që ne kërkuam dhe aspiruam për një bashkësi ndërkomtare për dhjetë vite para se të fillonte lufta, dhe jemi ndier që ne duhet të kemi respekt më tepër se që është e paraparë sipas dokumenteve, rregulloreve. Pas katër viteve te plota, çfarë është gjendja? Në dy vitet e para pati përparime marramendëse në Kosovë. Pastaj në vitin 2002, ai përparim filloi të ngadalësohet. Dhe nëse kjo rënie vazhdon, ne nuk do të arrijmë të fillojmë me ekonominë dhe inkuadrimin, do të kemi trazira shoqërore në Kosovë, dhe kjo do të keqë-

sonte mëtutje situatën politike.

Ne na duhet të kemi një hartë që të shohim për sa gjatë - çfarë ndihme na duhet që të realizojmë qëllimet tona. Kjo do të përforconte bashkëpunimin e institucioneve vendore me UNMIK-un. Ne nuk po arrijmë dot deri tek ligjet që çojnë në një jetë normale në Kosovë - të drejtësisë, sigurisë dhe ekonomisë. Unë ndiej që, tani është koha më e mirë për të bërë një hartë të tillë. Kjo do të stabilizonte situatën politike dhe do të bënte jetën më të lehtë

Derisa harta të jetë gati, siç sugjeroni ju, kompetencat do të dorëzoheshin, që do të nënkuptonte ngarkesë pune për Kuvendin. A keni filluar ju, si kryesi apo edhe përmes komisioneve parlamentare, të zhvilloni një strategji që do t'ua mundesonte të merreni me këtë ngarkesë pune në Kuvend?

Mendoj që kam gjetur formulën e saktë sesi të përshejtohet puna në Kuvend. Kryesia ka pranuar propozimin tim dhe unë shpesh po takohem me udhëheqësit e komisioneve parlamentare për të parë se ku qëndron problemi. Kështu që, mendoj se komisionet, kryesia dhe parlamentet janë tani të gats-

hëm për punën që është përkatëse për kuvendin.

Ju keni dy detyra, kryetarë i Kuvendit dhe anëtar i Kryesisë në LDK. Si i organizoni dhe balanconi këto dy detyra të ndryshme?

Nuk është detyrë e lehtë. Jam antar i LDK-së që nga ditët e para të saj. Gjithmonë kam qenë një opozitë konstruktive përbrenda LDK-së. Kam dashur të mbaj identitetin tim si njeri profesional, dhe njeri që ka pikëpamje goxha liberale për jetën dhe politikën. Unë kam respektuar programin e LDK-së por jo edhe nevojat ekstreme të partisë. Mendoj se kam qenë relativisht i pavarur përbrenda partisë, por asnjëherë s'kam punuar kundër partisë. Kjo më ka ndihmuar gjatë kohës dhe kjo më ndihmon edhe tani. Mendoj se kryetari i Kuvendit duhet të jetë më objektiv ndaj realitetit në vend dhe jo të ketë nevojat e partisë prioritet, por të ketë nevojat e elektoratit, nevojat e njerëzve për prioritet. Nganjëherë kjo çon në probleme të mbrendshme për mua. Por unë jam gjithmonë i gatshëm të paguaj çmimin e strategjisë sime

Si ballafaqoheni me këtë kritikë? Njerëzit thonë se ju po veproni si antar



Me 5 qershor, Z. Sollana vizitoi vendet ballkanike para samitit të UE në Selanik. Me 5 qershor, Z. Sollana përfaqësues i lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, u takua me profesor Dacin, Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, para seancës plenare të Kuvendit. Z. Sollana vizitoi vendet ballkanike para samitit të UE në Selanik.

i LDK-së, ndërkohë që ju faktikisht thoni : " Jam kritik ndaj partisë sime, por unë punoj për Kosovën."

Unë do t'i përmbahem këtij qëndimi, madje edhe radikalët në LDK kanë filluar të kuptojnë dhe në një mënyrë të përkrahin qëndrimin tim, sepse është rruga e vetme që do të çojë Kosovën në integrimin evropian dhe veriatlantik. Unë nuk e kam problem të jem i drejtpërdrejtë në mediat kosovare dhe të them që gjithë minoritetet duhet të kenë të drejta të barabarta, të njëjtat të drejta si fëmijet e mi dhe unë. Edhe nëse sukseset janë të vogla ato

janë prezente dhe shihen çdo ditë. Nëse vështroni punën në Kuvend, nëse analizoni rregullat e procedurave, ato janë plotësisht kompatible me procedurat ndërkomtare.

Flitet shumë për bisedimet Prishtinë- Beograd. A do të ishit të gatshëm të takoheni me kryetarin e Kuvendit të Sërbisë

Absolutisht, po. Ne nuk duhet të jemi të fiksuar nga kompleksi i inferioritetit. Unë do ta takoja cilido kryetar të kuvendit në fqinjësi apo në botë. Biseda dhe takimi me njerëz është mënyra e vetme të shprehin nevojat e vendit tënd.

Zhvillimet e fundit në Kuvend

Gjatë dy muajve të fundit Kuvendi i Kosovës ka zhvilluar debate intensive, ka marrë vendime dhe iniciativa dhe ka miratuar ligje shumë të rëndësishme për shoqërinë e Kosovës. Në vijim kemi paraqitur një pasqyrë të zhvillimeve të fundit politike, prej mesit të prillit deri në mes të qershorit 2003.

Franklin De Vrieze

Debati mbi legjislationin e zgjedhjeve

Në seancën plenare të 24 prillit Kuvendi diskutoi dhe miratoi iniciativën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) me anë të së cilës kërkohet nga Kuvendi i Kosovës që të miratohet një ligj mbi zgjedhjet. Koalicioni Kthimi (KK) paralajmëroi se miratimi i një ligji të tillë nga Kuvendi do të kontribuonte në përçarjen midis komuniteteve etnike në Kosovë. UNMIK-u kundërshtoi vendimin për shkak të uzurpimit të kompetencave mbi çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet, të cilat në mënyrë ekskluzive i takojnë UNMIK-ut, sipas Rezolutës 1244 të KS KB-së. OSBE-ja e ritheksoi përkushtimin e saj që t'i ndihmojë Grupit Punues të Zgjedhjeve (GPZ) si organ i caktuar për t'u marrë me çështjet e zgjedhjeve, si mjete të përgatitjes së rekomandimeve të pavarura për t'i ofruar këshilla PSSP-së. GPZ-ja është duke vazhduar punën e vet në mënyrë të rregullt.

Propozimi i moratoriumit mbi statusin përfundimtar

Gjatë muajit prill janë zhvilluar debate intensive mbi propozimin e liderit të PDK-së z. Hashim Thaçi për një moratorium mbi statusin përfundimtar të Kosovës. Z. Thaçi është përkrahur nga përfaqësitë e zyrtare kryesore në Prishtinë si dhe nga UNMIK-u, por pothuajse të gjitha partitë politike shqiptare të Kosovës kanë shprehë pakënaqësinë dhe kritikën e tyre. LDK-ja dhe Aleanca

për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) së bashku me të tjerët e hodhën poshtë propozimin si joreal dhe si një hap i cili mund të cenojë pavarësinë e Kosovës. Lideri i grupit parlamentar të KK, z. Dragisha Kërstoviq e përkrahu propozimin, përderisa ish liderja e këtij grupi parlamentar znj. Rada Trajkoviq, e cilësoi këtë ide si "shumë të rrezikshme". Më 18 prill Këshilli i Përgjithshëm i PDK-së lëshoi një deklaratë lidhur me moratoriumin, në të cilën thuhet: "PDK-ja është duke bërë përpjekje

Kryetari i PDK-se dhe antari i Kuvendit të Kosoves, Hashim Thaçi, biseduan propozimin e tij për moratoriumin mbi statusin final të Kosoves me PSSP Michael Steiner.



që të arrijë një marrëveshje për përcaktimin e një afati kohor për zgjidhjen e statusit të Kosovës" dhe njëherësh "kërkon nga Kuvendi dhe Qeveria që ta fillojnë procedurën për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese".

Korrigjimi i projektligjeve të miratuara

Më 15 prill 2003 PSSP-ja z. Michael Steiner i dërgoi një letër prof. Nexhat Dacit, Kryetarit të Kuvendit, duke kërkuar që katër ligjet, të cilat tanimë kishin kaluar në Kuvend, të rishikohen dhe të harmonizohen me Kornizën Kushtetuese dhe Rezolutën 1244 të KSKB-ra para se të dërgohen në zyrën e tij për miratim përfundimtar. Këto ligje janë: Ligji mbi Telekomunikacionin, Ligji mbi Tregtinë e Jashtme, Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike, dhe Ligji mbi Shkollimin e Lartë. Njëherësh në letër ishte përcaktuar edhe afati i fundit - 30 prilli (shih numrin e kaluar të Buletin Informativ të

IPK-së). Meqë komisionet përkatëse filluan të takohen për t'i adresuar kërkesat e UNMIK-ut pas propozimit të prof. Dacit, PSSP-ja z. Steiner ra dakord që të shtyhet afati i lartëpërmendur deri në 12 maj. Në seancën plenare të 8 majit, Kuvendi miratoi rekomandimet e komisioneve funksionale relevante përkitazi me ndryshimet e propozuara nga UNMIK-u. Sa i përket dy ligjeve të para, të gjitha kërkesat për ndryshime të UNMIK-ut u inkorporuan. Ndërkaq kur bëhet fjalë për ligjin mbi menaxhimin e financave publike kërkesat u inkorporuan vetëm pjesërisht. Kuvendi nuk e ka rishqyrtuar projektligjin mbi shkollimin e lartë, pasi që nuk është arritur marrëveshja mbi formulën për njohjen e fakulteteve në Mitrovicë. PSSP-ja miratoi ligjin mbi tregtinë e jashtme dhe ligjin mbi telekomunikacionin pas ndryshimeve dhe përmirësimeve të bëra nga Kuvendi. Më 13 maj, PSSP-ja miratoi edhe dy projektligjet tjera, Ligjin mbi Shkollimin e Lartë dhe Ligji mbi Mena-

xhimin e Financave Publike, pas përmirësimeve dhe ndryshimeve që u bënë në mënyrë të njëanshme nga ana e Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut.

Përderisa tensionet në mes të UNMIK-ut dhe Kuvendit rreth miratimit të ligjeve kanë përfunduar - së paku tani për tani - Ligjin mbi Shkollimin e Lartë në veçanti për Ministrinë e Arsimit të Kosovës mbetet ende një sfidë, ngase ajo duhet të sigurojnë zbatimin e plotë të tij.

Rishikimi i kodeve kriminale

Më 28 mars PSSH-ja Z. Steiner i ka dërguar draftin për kodin e përkohshëm kriminal dhe draftin për procedurat e përkohshme të kodit kriminal, institucioneve të Kosovës për t'i rishikuar dhe për të dhënë mendimin dhe komentet e tyre. Në pajtim me kompetencat e rezervuara të PSSH-së, këto projektligje do të miratohen sipas Rregullores së UNMIK-ut, por z. Steiner shprehi dëshirën që institucionet e Kosovës të angazhohen plotësisht në këtë iniciativë të rëndësishme ligjore. (shih numrin e kaluar të Buletinit Informativ të IPK-së).
Më 8 maj seanca plenare

e Kuvendit ka shqyrtuar rekomandimet e Komisionit mbi Çështjet Gjyqësore, Legjislative dhe të Kornizës Kushtetuese. Si ushtrues i detyrës së kryesuesit të Komisionit, z. Kolë Berisha (LDK) deklaroi se kodet ishin hartuar mirë, prandaj Komisioni ka vetëm ca vërejtje. Z. Dragisha Kërstoviq paraqiti mendimin e KK-së dhe theksoi se Kodet paraqesin shkeljen e Rezolutës 1244 të KSKB-së dhe të integritetit territorial të Serbisë dhe Malit të Zi. Pas një debati intensiv u sugjeruan disa ndryshime të vogla teknike.

Gjatë seancës së 15 dhe

22 majit Kuvendi votoi që t'i përkrahë kandidaturat e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve përveç njërit, ashtu siç është sugjeruar nga Komisioni mbi Çështjet Gjyqësore, Legjislative dhe të Kornizës Kushtetuese, pas rekomandimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës.

Miratohet rezoluta mbi Luftën për Liri

Gjatë seancës së rregullt plenare të 15 majit, Kuvendi miratoi një rezolutë mbi "Luftën Çlirimtare të Popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi". Pas iniciativës

së AAK-së dhe me përkrahjen e PDK-së, ideja për miratimin e rezolutës mbi vlerat e luftës çlirimtare është diskutuar në mesin e partive shqiptare të Kosovës si dhe në Kuvend që nga fillimi i marsit (shih numrin e kaluar të Buletinit Informativ të IPK-së). Është arritur një marrëveshje me LDK-në rreth gjuhës së përdorur në rezolutë, në të cilën përfshihen si lufta e armatosur e udhëhequr nga UÇK-ja, ashtu edhe rezistenca paqësore e udhëhequr nga LDK-ja. Në rezolutë më tutje thuhet se, "lufta politike dhe e armatosur për lirinë dhe

pavarësinë e Kosovës [...] ka vënë themelet e një shoqërie moderne, të lirë dhe demokratike për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga pikëpamjet politike, religjioni, përkatësia etnike dhe racore". Rezoluta njëherësh kërkon nga Qeveria e Përkohshme që të përgatisë një ligj i cili do të "rregullojë statusin e luftëtarëve për liri" si dhe të ofrojë kompenzim për ta.

PSSH-ja ka reaguar menjëherë dhe ka lëshuar një deklaratë me të cilën kritikon rezolutën si "pëçarëse dhe kundër frymës pajtuese që është paraparë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe në Kornizën Kushtetuese". Ai më tutje paralajmëroi se në ditën e aktit të Kuvendit nikoqirët e tri takimeve të ardhshme ndërkombëtare - Këshilli i NATO-s në Bruksel, Konferenca Parlamentare e Faktit të Stabilitetit në Bruksel, dhe Konferenca Rajonale e Faktit të Stabilitetit e UE/NATO-s/OSBE-së në Ohër - kanë vendosur që të mos i ftojnë përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës për të marrë pjesë në këto takime.

Lideri i KK-së në Kuvend, Dragisa Kërstoviq, vuri në dukje se rezoluta është porosi e qartë për serbët e



Mesazh nga Zyra Amerikane

Reno L. Harnish III, Chief of Mission, US Office Pristina

Jam i kënaqur që redaktorët e buletinit informativ të ASI-të na dhanë rastin që t'i shfaqim opinonet tona lidhur me punën e rëndësishme të Kuvendit të Kosovës. Në vitin e kaluar ky institucion i përkohshëm i vetqeverisjes, ishte ngritur në një trup legjislativ të aftë për formësimin e bazës së shoqërisë kosovare. Anëtarët e Parlamentit kanë prekur një sërë çështjesh të rëndësishme gjatë 12 muajve të fundit. Si politikanë të zgjedhur, që t'i shërbeni popullit të Kosovës në Kuvendin Legjislativ, ju keni pranuar një bagazh unik sfidash. Dhe në këto momente gjendja e juaj nuk është aq e lehtë. Por, për shumë çështje me rëndësi të madhe, ju keni gjetur kompromis që të ecni përpara dhe që të përmirësoni jetën e njerëzve që përfaqësoni. Dhe për këtë, ne ju përgëzojmë!

Një nga prioritetet më të rëndësishme si për Kosovën ashtu edhe për bashkësinë ndërkombëtare është përforsimi i rrjetit të mirëqenies shoqërore për të përmirësuar jetën e njerëzve këtu. Anëtarët e Parlamentit janë përballur me problemet e vërteta të Kosovës. Duke iu falenderuar punës suaj, ligjet mbi pensionin dhe



arsimin janë avancuar për një miratim nga ana e PSSP-së. Rishtazi, Ministria e Punës ka prezantuar një draft propozim të ri të Ligjit mbi ndihmat sociale, i cili është përpiluar që të plotësojë zbrazëtirat në shërbimet sociale.. Do të ketë natyrisht, pika në këtë Ligj që do të jenë kontestuese, por ne jemi të bindur se të gjitha palët do të punojnë së bashku që t'ju rreken këtyre dhe ligjeve të tjera ne frymën

e një bashkëpunimi dhe respekti të ndërsjellë, me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe cilësisë së jetës në Kosovë.

Në Zyrën Amerikane, ne jemi vazhdimisht të preokupuar dhe të angazhuar rreth gjetjes së mënyrave më të përshtatshme për ta rigjallëruar sa më parë ekonominë e Kosovës. Ju po bëni çmos që të miratoni ligje për t'iu mundësuar biznismeneve lokalë dhe investitorëve me perspek-

tivë që të investojnë. Ligjet e reja mbi të drejtat e pasurisë së patundshme, tregtisë së jashtme, telekomunikacion, inspektim të punës, likuidim dhe bankrotim, madje edhe mbrojtje të ambientit, janë duke hapur rrugë për revitalizimin ekonomik të rajonit. Veç kësaj, janë edhe ca draft ligje me rëndësi të veçantë, të cilat momentalisht janë në shqyrtim, si ligji mbi qasjen në dokumentet zyrtare dhe ai për planifikim hapsinor.

Ne ju inkurajojmë juve, deputetë të Parlamentit, që të vazhdoni të përqëndroheni dhe të angazhoheni në rregullimin e biznesit dhe miratimin e ligjeve praktike që do të sjellin një prosperitet ekonomik në këtë rajon të pazhvilluar. Përpos kësaj, është me rëndësi që ju të shqyrtoni edhe çështje të rëndësishme taksash, si taksa e shtuar mbi vlerën. Njëherësh, që të vini në binar dhe të de-politizoni procesin e dhënies së lejeve me qëllim të përshtatimit dhe zgjerimit të biznesit dhe tërheqjes së investitorëve me perspektivë. S'ka pikë dyshimi se duhet kaluar një rrugë e gjatë për arritjen e këtyre qëllimeve pra, për të ndër-tuar një shoqëri të sigurtë, stabile dhe në harmoni

multi-etnike, e cila do të sillte Kosovën në rrugën e drejtë për integrim në BE.

Sikur vetë Kosova, ashtu edhe Kuvendi i saj është në një udhëkryq kritik. Vitin e ardhshëm, të gjithë deputetët duhet të bashkohen që të marrin përgjegjësinë e plotë për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit. Ju tani keni përgjegjësinë e rregullimit të projekteve buxhetore operative, për zgjerimin e hapësirës në ndërtesën e Kuvendit dhe për përmirësimin e infrastrukturës së saj. Unë shpresoj se të gjithë anëtarët e Kuvendit do të bashkëpunojnë ngushtë me sekretariatit lokal së pari, që të identifikojnë fushat e prioriteteve për përmirësim, dhe më pas për t'i përfshirë këto përmirësime të propozuara,

në buxhetin e juaj operativ. Ju duhet ta ndihmoni veten tuaj që të qeverisni më me efikasitet. Infrastruktura e përmirësuar dhe e përforsuar e teknologjisë informative, shërbimet cilësore dhe efikase të përkthimit, do të ndikojnë në rritjen e kapacitetit të të gjithë deputetëve të Kuvendit për pjesëmarrje më efikase në punën e Kuvendit.

Në vitin e ardhshëm unë shpresoj se ju do t'i kush-

toni kohë dhe do të angazhoheni edhe më tepër në ndërtimin e një shoqërie multi-etnike në Kosovë. Nuk është me rëndësi se a e zgjidhni Kanadën, Zvicrën, Belgjikën apo ndonjë model tjetër mutli-lingual, por është me rëndësi që PISG-ja të arrijë një koncensus në nivelin vendor rreth asaj se si të ofrohen shërbime publike të cilësisë më të mirë për çdo qytetar të Kosovës. Kjo nënkupton institucionalizimin e vërtetë të politikës për përdorimin e gjuhës që do t'ua mundësonte gjitha komuniteteve të Kosovës të kenë qasje të mirëfilltë në qeverisje dhe arsimit në gjuhën e tyre.

Gjatë gjashtë muajve të kaluar, Kuvendi ka shqyrtuar disa rezoluta mjaft të politizuara. Kjo dukuri, duke kaluar nëpër faza të ndryshme delikate, në fund të fundit vetëm sa do ta pengojë PISG-në që ta realizojë qëllimin e tij për integrimin etnik dhe njëherësh do ta prishë imazhin e Kosovës në botë. Ka mënyra të tjera, që janë më pak përçarëse, për t'i sendërtuar idealet dhe qëllimet tuaja. Mua në veçanti, më ka rënë në sy koha dhe energjia e shpenzuar në avokimin e një rezolute për pavarësinë e Kosovës - rezolutë kjo e cila nuk do të kishte kurrfarë efekti legal. Çështja e pa-

varësisë, është natyrisht, e ngrirë përderisa komuniteti ndërkombëtarë, që punon dhe vepron sipas rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së, të jetë i gatshëm të fillojë të merret me këtë çështje.

Unë ju këshilloj dhe ju lutem që - si përfaqësues të zgjedhur - t'i përqëndroni energjitë tuaja në debate të mirëfillta për çështje të rëndësishme. Kushtoni rëndësi me tepër çështjeve substanciale dhe praktike të proceseve demokratike, d.m.th atyre çështjeve ku ju keni mundësi të bëni ndryshime. Përkrahni debatet e hapura. Është e kuptueshme që në mesin e partive dhe individëve do të ketë mospajtime dhe debate rreth pikave dhe pjesëve të rëndësishme të ligjeve. Fundja, mungesa e debatit, është dobësi e çdo organi ligjvënës. Një legjislaturë mund ta arrijë ekuilibrin politik vetëm atëherë kur aty shprehen mendimet, idetë dhe idealet e ndryshme dhe që nuk pajtohen në frymën e respektit të ndërsjellë. Thënë shkurt kjo është domethënia e procesit demokratik. Dhe kjo, më tepër se çdo gjë tjetër do të bëjë dhe do të ndikojë që populli i Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare ta konsiderojnë Kuvendin ashtu siç është - institucion domethënës, i rëndësishëm, këshilldhënës dhe legjitim i vetqeverisjes.

Vijimi nga faqja 7

zhvendosur të cilët kthehen në Kosovë, se ata janë "të padëshirueshëm" dhe se është e pamundur të jetohej së bashku. Anëtarët e KK-së e lëshuan seancën e Kuvendit në shenjë proteste pak para se të fillojë votimi mbi rezolutën. Lideri i grupit parlamentar të PDK-së Arsim Bajrami gjatë debatit vuri në dukje se kjo rezolutë ka kontribuar në përmirësimin e dialogut në mes të partive shqiptare të Kosovës.

Propozohet dialogu PDK - KP

Një nismë, nga Kryetari i PDK-së z. Hashim Thaçi, për të zhvilluar bisedime me anëtarët e KK-së në mënyrë që të përmirësohen raportet midis komuniteteve etnike në Kosovë ka zgjuar interesim të madh në mediat vendore. Pohohet se KK-së i është bërë një ftesë jozyrtare me 9 maj, mirëpo burimet e PDK-së me 12 maj njoftuan se kjo parti do t'ua dërgojë një ftesë të tillë zyrtare vetëm nëse me këtë nismë paraprakisht pajtohen edhe të gjitha partitë tjera politike në Kuvendin e Kosovës. Derisa zyrtarët e KK-së reagojnë pozitivisht ndaj kësaj nisme, politikanët serb të Kosovës më vonë e anu-

luan pjesëmarrjen e tyre -duke e arsyetuar këtë me miratimin e rezolutës së sipërpërmendur më 15 maj.

Dënohet vrasja e tre civilëve serb

Procesi i pajtimit ndëretnik dhe procesi i kthimit përjetoj stagnim me vrasje brutale të çiftit të moshuar serb dhe të birit të tyre të rritur, në shtëpinë e tyre në Obiliq më 3 qershor. Shtëpisë së viktimave i është vënë zjarri në mënyrë që të fshihen vrasjet. PSSP-ja dhe KM Bajram Rexhepi vizituan vendin e ngjarjes, dhe që të dy dënuan ashpër këtë sulm të dhunshëm. Komuniteti politik përfshirë këtu Kryetarin e Kosovës, Qeverinë, Kryetarin e Kuvendit dhe liderët e partive më të mëdha politike - të gjithë njëzëri dënuan vrasjet. Veç kësaj, liderët politik shqiptarë të Kosovës dhe shtypi, shprehën shqetësimin e tyre lidhur me pasojat që krimi në përgjithësi po i shkakton imazhit të Kosovës në botë, e në veçanti në dritën e vizitës së Havier Sollarës, Përfaqësuesit të Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri të UE-së. Deklaratat që bënë nga komuniteti dhe politikanët serb theksuan se situata e sigurisë po

ushtron një ndikim negativ në procesin e kthimit të PZHV-ve (Personave të Zhvendosur brenda Vendit). Njëherësh, përfaqësuesit e KK e braktisën edhe mbledhjen e Kuvendit të Kosovës të mbajtur me 5 qershor në shenjë proteste ndaj vrasjeve të fundit.

Miratohen Ligjet

Gjatë dy muajve të fundit Kuvendi miratoi disa ligje. Ca nga këto ligje tashmë janë miratuar pas shqyrtimit të dytë në datën e përmendur. Ligjet pa afat janë miratuar qysh në shqyrtimin e parë, por janë -që nga mesi i qershorit- ende në shqyrtim në komisionet e Kuvendit: Ligji mbi Arkivat (17/04), Ligji mbi Tatimin në Pasurinë e Patundshme (17/04), Ligji mbi Kooperativat e Farmerëve (15/05), Ligji mbi Rugët (29/05), Ligji mbi Plehërat (22/05), Ligji mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare, Ligji mbi Popullsinë e Kosovës dhe Regjistrimin e Ekonomive Familjare, Ligji mbi Prokurorinë Publike në Kosovë, Ligji mbi Ndryshimet dhe Korrigjimet në Ligjin mbi Krizimin e të Drejtës së Regjistrimit të Pasurisë së Patundshme, Ligji mbi Planifikimin Hapësinor, Ligji mbi Planin e Ndhmës Sociale.

“Nuk kemi investuar mjaft në strukturat për hartimin e ligjeve”

Z. Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë së Kuvendit nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), vlerëson punën e Kuvendit të Kosovës dhe të grupit të tij parlamentar.

Intervistoi Shpresa Mulliqi dhe Shahriniso Najmetdinova

Zoti Kosumi, tashmë ka kaluar më shumë se një vit që kur është konstituuar Parlamenti i parë pluralist i Kosovës. Çfarë është arritur? A është miratuar ndonjë ligj?

Tashmë kemi aprovuar afro 20 ligje, ndërsa në procedurë janë më shumë se dhjetë ligje tjera. Për një Kuvend i cili sapo i ka mbushur një vit, kjo nuk është pak. Por, duhet t'i marrim parasysh kushtet e punës. Për shembull, deputetët e Parlamentit tonë nuk kanë zyra dhe nuk kanë ku të rrijnë. Ata janë të detyruar të takohen në bufetin e Kuvendit.

Sidoqoftë, po e theksoj se çfarë është arritur deri më tash nuk është diçka që mund të injorohet. Madje edhe në këto rrethana, Kuvendi e ka kryer punën e tij. Ky mund të quhet sukses. Megjithatë, nevojat e vendit tonë për legjislacion dhe për vënjen e shumë segmenteve të jetës sonë brenda kornizave ligjore janë shumë më të mëdha se sa ato që kemi arritur t'i përmbushim deri

më tani. Edhe pse në Kosovë zbatohen ligjet e ashtuquajtura të aplikueshme, këto ligje janë rixjerrur kryesisht 20 vjet më parë, apo edhe më herët, pra janë ligje të vjetra, të cilat në fakt ngjallin një lloj neverie tek qytetarët e Kosovës.

Si ndërkombëtarët, ashtu edhe vendorët, e fajësojnë Kryesinë e Kuvendit për mosnxerjen e një numri më të madh të ligjeve. A ekziston ndonjë arsye apo pengesë për miratimin e më shumë ligjeve?

Së pari - “përgatitja” apo hartimi i projektligjeve. Nuk presin sirtarët e Kuvendit me ligje të pamiratuara. Madje, madje, ato ligje që na arrijnë në Parlament ne me një procedurë shumë të shpejtë prej një apo dy javësh i miratojmë. Problemi në fakt qëndron tek (pa)mundësia e hartimit të projektligjeve. Qeveria e Kosovës, Kuvendi, por edhe institucionet tjera, duke nënkuptuar këtu edhe UNMIK-un dhe Përfaqësuesin Special, nuk kanë

investuar në strukturat që duhet t'i hartojnë projektligjet.

Së dyti - promulgimi i ligjeve. Thënë kushtimisht, PSSP-ja e ka marrë një ves të keq që t'i ndalojë ligjet e miratuara në Kuvend, duke i promulguar ato me një vonesë të madhe apo duke mos i promulguar fare. Si rrjedhojë, ekziston një konflikt permanent do të thosha ndërmjet Kuvendit dhe Përfaqësuesit Special.

Natyrisht se kohëve të fundit në këto çështje janë bërë disa kompromise, me të cilat unë nuk jam pajtuar. Unë nuk mund të pajtohem që ligji, i cili është miratuar një herë në Kuvend, të rikthehet përsëri për miratim. Ekziston vetëm një procedurë dhe unë dua që të angazhohem që kjo procedurë të respektohet. Por, PSSP ka qenë këmbëngulës, ka ngulur këmbë që ligjet e miratuara të diskutohen edhe një herë, siç ndodhi me katër ligje të miratuara nga Kuvendi kohë më parë. Kjo nuk mund të ndodh

në asnjë vend dhe në asnjë Parlament të botës demokratike.

Çfarë i shtyen zyrtarët e administratës ndërkombëtare që vijnë këtu me një pragmatizëm, do të thoshim, dhe me një bagazh të përvojës nga sistemet parlamentare demokratike e të bëjnë veprime që ju i quani të padrejta dhe të papranueshme?

Me sa duket, shumica e faktorëve politikë në Kosovë nuk janë duke i respektuar procedurat, përfshirë këtu edhe UNMIK-un. Kjo bëhet për shkaqe politike. Ky është shkaktari i asaj që unë e quaj obstruksion apo mjegullim të procesit politik. Disa politikanë serbë besojnë se sa më i paqartë që të jetë statusi i Kosovës, aq më mirë do të jetë për serbët dhe Serbinë. Në të vërtetë, duket se ky qëndrim po i nxit disa zyrtarë të UNMIK-ut që të sillen kështu siç po sillen në Kosovë, dhe në këtë mënyrë ta bëjnë gjendjen në Kosovë sa më të mjegullt që të jetë e mundur. Vagullim i

i së ardhmes së Kosovës është faktori numër një e pengon ecjen përpara të procesit. Kjo shkakton mungesë të vizionit, çfarë pengon investimet, por edhe qytetarin që të punojë me përkushtim dhe vullnet për ta ndërtuar të ardhmen e vet në Kosovë. Si mund ta investoj kapitalin tim në këtë vend, nëse nuk e di se cili do të jetë fati i atij kapitali pas katër vjetësh? Një pjesë e UNMIK-ut është duke e kushtëzuar si demokracinë, ashtu edhe progresin politik në Kosovë, duke favorizuar vullnetin politik të një minoriteti, gjegjësisht, të komunitetit serb.

A keni aluduar më herët në reagimin e UNMIK-ut ndaj miratimit të Rezolutës mbi vlerat e luftës, kur keni anuluar pjesëmarrjen e institucioneve të Kosovës në tri takime ndërkombëtare që janë mbajtur gjatë muajit maj? Së pari, rezoluta është përkrahur nga shumica e deputetëve të Kuvendit. Vetëm deputetët serbë e kanë kundërshtuar këtë



rezolutë. Së dyti, materia që e trajton kjo rezolutë i përket së kaluarës dhe nuk është kompetencë e rezervuar. Mbase Shtajneri nuk e ka rezervuar historinë tonë si kompetencë të tij. Së treti, Shtajneri edhe më herët është përpjekur t'i stopojë rezolutat e Kuvendit. Rezoluta miratohet vetëm një herë dhe e tërë bota të ngrihet në këmbë, ajo nuk mund të zhbëhet. Për deputetët e Kuvendit dhe për elektoratin, nga i cili ka dalë ky Kuvend, ajo është e plotëfuqishme dhe do të mbetet e tillë. D.m.th, Shtajneri mund të mos pajtohet me përmbajtjen, mund ta hedhë poshtë atë, por për Kuvendin e Kosovës dhe Kosovën ajo rezolutë mbetet sot e njëqind vjet e plotëfuqishme.

Fragmenti i rezolutës së fundit, për të cilin është reaguar është: "Lufta është bërë për lirinë dhe për pavarësinë e Kosovës." Kjo është e vërteta. NATO-ja ka ardhur në Kosovë që t'u ndihmojë qytetarëve të Kosovës, të cilët po shfahroseshin nga regjimi serb. Por, shqiptarët e Kosovës kanë luftuar kundër Beogradit, jo vetëm për një vit e gjysmë, por për një shekull të tërë. Lufta dhe gjaku i derdhur janë themel për shtetin e pavarur të Kosovës. Nuk është e lehtë që të ndëshkohet një institucion, aq më shumë një institucion çfarë është Kuvendi i Kosovës, i cili është krijuar nga vota e lirë dhe demokratike e qytetarëve. Vendimi i Shtajnerit ka qenë i ngutshëm dhe jodemokratik.

Megjithatë Z. Kosumi, pandehim se fërkimet e këtilla janë prezente edhe në shoqëritë që ekonomisht dhe politikisht janë më të zhvilluara se Kosova. Mbase nuk i shihni të gjitha kështu zi dhe pa nuanca?

UNMIK-u dhe institucionet e Kosovës bashkëpunojnë dhe do të vazhdojnë të bashkëpunojnë. UNMIK-u është në Kosovë për të ndihmuar në ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme dhe profesionale të Kosovës. Ndërsa UNMIK-u po e përmbush këtë mision. Fatmirësisht po vjen koha kur misioni do të përfundojë. Kemi qeveritë komunale dhe kuvendet komunale. Kemi Kuvendin e Kosovës, qeverinë dhe Kryetarin. Mekanizmat e shtetit janë krijuar, edhe pse gjykatat duken të politizuara. Ne do t'ia shfaqim UNMIK-ut mirënjohjen tonë të thellë për punën që e ka bërë në Kosovë. Jam i bindur se mund të priten edhe disa fërkime, meqë, nga njëra anë, institucionet dhe populli i Kosovës dëshirojnë që Kosovën ta bëjnë shtet, ndërsa, në anën tjetër, UNMIK-u nuk ka kompetenca që ta lejojë këtë, prandaj do të përpiqet ta pengojë këtë proces të pashmangshëm dhe historik të këtij vendi.

Z. Kosumi, çfarë mendoni se kanë qenë të arriturat e

grupit parlamentar të AAK-së gjatë vitit të kaluar? Grupi parlamentar i AAK-së ka qenë grupi më aktiv në Parlament. Të arriturat mund të përmbledhen në tri pika. Nën një, krijimi i konceptit të bashkëqeverisjes në Kosovë. Ne e kemi mposhtur konceptin tradicional, jo vetëm të Kosovës, por edhe të Ballkanit, se opozita dhe pozita janë armiq që duhet të luftojnë ndërmjet veti deri në fund. Suksesi i dytë është ndryshimi i Kornizës Kushtetuese, me ç'rast një anëtar i AAK-së iu bashkangjiti Kryesisë së Kuvendit. Edhe pse ky është një ndryshim formal, ne kemi hapur një derë të vogël dhe e kemi thyer tabunë që këtë kornizë e shihje si diçka të ngurt që nuk guxon dhe nuk mund të ndryshohet. Suksesi ynë i tretë ishte miratimi në Kuvend i Rezolutës mbi njohjen e vlerave të luftës për liri dhe pavarësi të qytetarëve të Kosovës.

A mendoni se në punën tuaj ka vend për kritika? Kemi nisur një procedurë të re për ta miratuar Deklaratën mbi pavarësinë e Kosovës. Ne nuk kemi mundur ta shtyejmë përpara këtë proces dhe ky proces është ndalur në gjysmë të rrugës. Kemi rënë dakord me katër grupe parlamentare që kjo çështje të hyjë në procedurën e Kuvendit. Liderët kryesorë po-

litikë dhe kryesuesit e grupeve parlamentare kanë vendosur që të bëjnë një marrëveshje në momentin kur kjo Deklaratë do të miratohet. Megjithatë, unë nuk e konsideroj këtë sukses.

Çfarë mendoni se duhet të jenë prioritetet e Kryesisë së Kuvendit?

Kryesia nuk mund të përcaktojë shumë priorite, sepse varet nga grupet parlamentare. Mendoj se liderët kryesorë politikë të Kosovës duhet ta kenë një platformë dhe një strategji për definimin e statusit tonë final. Ndoshta na lejohet të kemi mendime të ndryshme kur kemi të bëjmë me nene të ndryshme të projektligjeve, por nuk na lejohet të kemi mendime të ndryshme mbi mënyrën dhe kohën kur duhet të themelohet shteti i Kosovës apo mbi mënyrën e jetësisimit të demokracisë në Kosovë.

Miratimi i shumë ligjeve gjithashtu nënkupton përgatitje për ditën kur mund të konsiderojmë se shteti i Kosovës po funksionon si duhet. Kjo varet nga zhvillimi ekonomik. Nuk mund të kemi shtet, as proces të sukseshëm drejt ndonjë shteti apo procesi demokratik, nëse nuk ringjallet ekonomia, nëse nuk investohet kapitali dhe nëse nuk hapen vende të reja të punës.

Kuvendi zgjeron horizontet e tij

By Simon Haselock, Director, UNMIK Department of Public Information

Me vazhden pranverore të takimeve multilaterale ne të cilat janë ftuar perfaqësuesit kosovarë, është e qartë se po hyjmë në një fazë të re - në një fazë ku institucionet e Kosovës gjithnjë e më tepër do të ftohen të marrin pjesë në diskutime e struktura regjionale dhe evropiane.

Derisa institucionet e Kosovës mund të dyshojnë në fazën e kësaj lindjeje të re për ta, kjo fazë, poashtu nënkupton që Europa dhe Bashkësia nderkombëtare do të fillojnë të vlerësojnë Kuvendin e Kosovës dhe 11 ministrinë e saj për mënyrën se si ata do të përballen me çështjet praktike dhe pergjegjësitë që i presin.

Ne të njëjtën kohë, burrat dhe gratë e zgjedhur të Kosovës mezi presin të realizojnë qellimet e kuptueshme të tyre. Është e kuptueshme se ata do të ballafaqohen me sfida të reja dhe do t'i shtyjnë mëtej kufijtë. Ne këtë atmosferë, jeta e vërtetë dhe çështjet pragmatike nganjëherë kanë ngelur prapa fitoreve simbolike politike.

Është e rëndësishme tani për Kuvendin që të involvohet në fushat që kanë ndikim në jetën e njerëzve, si në: shëndetësi, arsim, ekonomi dhe shërbime shoqërore - nëse dëshiron të dëshmojë

para Këshillit të Sigurimit dhe botës se është e gatshme të marrë përsipër detyrat e saj. Qeverisja e mirë matet, jo nga sasia e kompetencave që kanë institucionet, por nga ajo sesa u shërbejnë qytetarëve të tyre.

Asnjë sistem parlamentar në botë nuk e ka lirinë e plotë të qeverisjes. Çdo sistem demokratik ka kontrollet dhe balancet në vende që mbrojnë qytetarët dhe perspektivat e tyre afatgjata nga nazet apo teket politike.

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, një prej kushtetutave më të vjetra në botë, është ndryshuar 27 herë gjatë 200 vjetëve, dhe vetëm 12 herë në shekullin e kaluar. Të ndryshosh një dokument të tillë nuk është lehtë

dhe kjo ka arsytet e veta. Ish kryetari i SHBA-ve Xherald Ford ka deklaruar: "Kushtetuta jonë funksionon sepse republika jonë e madhe është qeveri e ligjeve dhe jo e njerëzve".

Kosova sot, edhe pse nuk është shtet, posedon sistemin e vet të kontroleve dhe balanceve me nenin 1244 të OKB-së dhe Kornizës Kushtetuese. Para se të shikojnë për mundësitë përtej këtyre strukturave, institucionet e Kosovës duhet të pranojnë sfidat e qeverisjes mbrenda kësaj kornize të punës, sepse kjo është baza mbi të cilën bota do të gjykojë punën e tyre.

Roli i UNMIK-ut, nuk u kundërvihet vullnetit të njerëzve, siç pohojnë disa, është që të punojë me Kuvendin për të siguruar

se Korniza Kushtetuese dhe Neni 1244 respektohen. UNMIK do të intervenojë vetëm atëherë kur këto dokumente të shkelen, sikur në rastin e Ligjit për Arsim të Lartë.

UNMIK-u, i mandatar për të mbrojtur të drejtat e gjithë komuniteteve, kohën e fundit ka shpallur një plotësim për Ligjin mbi Arsimin, që thotë: "gjithë njësitë e arsimit të lartë të cilat kanë qenë të autorizuar të funksionojnë gjatë vitit akademik 2001-2002 do të jenë të licencuara me këtë Ligj". Kjo efektivisht riafirmton përfshirjen e universitetit në gjuhën sërbe në Mitrovicën Veriore, në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës, kurse tani implementimi i suksesshëm i Ligjit nga Ministria e Arsimit të Kosovës, do të sigurojë përfshirjen e Kosovës në strukturat e arsimit evropian.

Nëse ruan gjakftohtësinë në debat, do të jesh në gjendje të kuptosh mençurinë e posedimit të kontroleve të tilla në vend. Si do të kuptonte bota mohimin e se drejtës për arsim në gjuhën e nënës ndonjë minoriteti, pavarësisht çfarë mund të jenë komplikimet në situatën politike?

Sa absurde do të ishte

sikur që shqiptarët nga ish RSFJ-ja, të cilët ia dolën të krijojnë sistemin e arsimit në gjuhën e tyre, në ndërkohë në Kosovë, të shihen se po përpiqen të mohojnë këtë të drejtë për komunitetin më të madh joshqiptar në Krahinë.

Në këtë mënyrë Korniza Kushtetuese ka ndaluar Kuvendin e Kosovës nga një akt që do të kishte pasoja negative afatgjate për Kosovën.

Arritja e qëllimeve të larta politike dhe puna e zellshme nuk janë patjetër të barazuara me njëra tjetrën, por është një proces dhe një rend që duhet pasuar. Sot është e qartë, se detyra më e rëndësishme e insitucioneve të përkohshme vetqeverisëse të Kosovës është që t'i tregojë bashkësisë nderkombëtare se mund të qeverisin mirë me popullin e Kosovës në kohën kur po punohet mbrenda strukturave të tanishme kushtetuese, të Nenit 1244 të KS të OKB-së dhe Kornizës Kushtetuese.

Ata janë duke ecur mbarë, por akoma nuk kanë arritur të bëjnë këtë. Sa më shpejt që të arrijnë këtë, aq më parë institucionet e Kosovës do të jenë me afër integritet në familjen evropiane.



PSPP Michael Steiner në drekë pune me Kryesinë e Kuvendit, me 25 mars 2003

Parlamentarët minoritarë tentojnë të gjejnë rrugën e tyre drejt mediave

OSBE-ja drejtoi sesionin e parë trajnues mbi informimin publik me anëtarët e Kuvendit të Kosovës.

Lydia Lecheva, Ekipi për Përkrahjen e Kuvendit- OSBE

Parlamentaret duhet gjetur menyra që të transmetojnë pikëpamjet e tyre edhe jashte forumeve politike. Kjo nenkupton bisedat me media, krijimin e marrëdhënieve që sigurojnë raportime të drejta dhe efikase. Grupi i katërt për nga madhësia në Kuvend, nuk përfaqëson një komunitet apo parti politike, për më tepër, përfaqëson "Komunitetet tjera", respektivisht të pesë grupet etnike: boshnjakët, turqit, goranët, ashkalinjtë dhe romët. Duket se mediat besojnë se në nivelin qendror vetëm pikëpamjet e partive të mëdha apo vetëm ato të komunitetit shqiptar, janë me interes për të gjithë. Kjo është e vërteta edhe për mediate lokale, poashtu. Për të ndihmuar këtë grup, në kuadrin e aktiviteteve të saja për ngritjen e aftësive, OSBE-ja ka përgatitur një projekt pilot mbi mënyrën e qasjes ndaj mediave dhe mbi përdorim e mediave si

mjet për të përcjellur një porosi. Kjo është hera e parë që OSBE-ja ka mbajtur një trajnim për media me anëtarët e Kuvendit të Kosovës. Ky projekt pilot është përgatitur dhe organizuar për anëtarët e grupit të Komuniteteve Tjera me qëllim që t'i ofrohen atyre mjetet për prezantimin e pikëpamjeve të tyre në mënyrë që ato të merren parasysh dhe të raportohen me korrektësi si në mediat vendore ashtu edhe në ato lokale të Kosovës. "S'ka pikë dyshimi se ne si liderë politikë jemi të interesuar për të komunikuar me gazetaret. Por si një grup parlamentar ne akoma nuk mund të dëgjohemi në mediat qendrore të Kosovës", pohon z. Sadik Idrizi, zëdhënës dhe kryesues i grupit parlamentar. Trajnimi ka zgjatur një muaj dhe është ndarë në tri module: nga një në

çdo javë. Në seancën e parë, të mbajtur me 13 maj, pjesëmarrësve u është ofruar një pasqyrë e përgjithshme e strukturës dhe hapësirës mediale në Kosovë dhe njëherësh iu janë dhënë sqarime elementare për marrëdhëniet me mediat. Grupi dha një shembull lidhur me sfidat dhe problemet me të cilat ata përballen gjatë punës me media. "Në përfundim të një mbledhje të grupit tonë parlamentar, kemi shprehur mospajtimin tonë përkitazi me sugjerimin e LDK-së që ligji mbi zgjedhjet të konsiderohet përgjegjësi e Kuvendit të Kosovës. Kësisoj ne bëmë deklaratën tonë në seancën plenare në një mënyrë demokratike, duke prezentuar argumentet tona në favor të vendimeve të grupit tonë parlamentarë. Të nesërmen, në kryetitullin e një gazete të Kosovës shkruante: "Serbët votuan kundër dhe turqit ishin me ta", theksoi z. Gani

Sadiku, parlamentar nga grupi i Komuniteteve Tjera. Një deputet tjetër i Kuvendit shtoi, "mediat qendrore të Kosovës janë politikisht të verbëra dhe nuk janë të interesuara për zërin e komuniteteve joshqiptare dhe josërbe".

"S'do mend se ju nuk jeni prioritet për mediat vendore të Kosovës", vuri në dukje një nga trajnerët e OSBE-së. - "Thjeshtë, duhet bërë përpjekje për të tërhequr vëmendjen mediave. Çfarë keni bërë ju në këtë drejtim?"

Tema e pjesës së dytë të trajnimit ka qenë lidhur me mënyrën e realizimit të intervistës së mirë televizive. Kështu që çdonjëri nga parlamentarët e "Komuniteteve Tjera" është xhiruar nga një kamerë televizive, e TV 21-shit, me ç'rast është dashur t'i përgjigjet një numri pyetjesh të "pakëndëshme" politike. Më pas, anëtarët e Kuvendit dhe trajnerët - Florin Pasnicu, Zyrtarë i Lartë për Informim Publik dhe Sven Lindholm, Zëvendës i Zëdhënësit të OSBE-së - analizuan xhirimet, me vështirësi dhe theks të veçantë në përmbajtjen e përgjegjeve dhe lëvizjet tru-

pore të të intervistuarit. Kjo pjesë e trajnimit ishte mjaft interesante dhe zbatimëse për të gjithë dhe që të dyja palët e pëlqyen dhe mësuan shumë nga sesioni.

Në pjesën e tretë u bë fjalë për mënyrën se si të organizohet një konferencë shtypi, si të shkruhet një komunikatë e mirë për shtyp, si dhe për njohuritë elementare mbi mënyrat e veprimit dhe komunikimit gjatë ndonjë situatë të krizës.

Pjesa e fundit do të jetë një mbledhje në mes të gazetarëve më të spikatur shqiptarë që punojnë me Kuvendin e Kosovës dhe parlamentarëve nga grupi "Komunitet Tjera" në një ceremoni, me ç'rast këtyre të fundit do t'u ndahen çertifikatat e OSBE-së për trajnim.

Topi tani është në fushën e ekipit të "Komuniteteve Tjera". Këta parlamentarë duhet të luajnë me mediat nëse donë që elektorati i tyre të dijë se çfarë kanë bërë dhe sa kanë qenë efikas ata në Kuvend. Uinston Qerqili, me një rast pat thënë se nëse mediat nuk raportojnë për punën e qeverisë, atëherë kjo do të thotë që nuk ka qeveri të mirëfilltë.



“Roli ynë nuk është të marrim vendime, por të ndikojmë në vendime”

Intervistë me Oliver Ivanoviqin, anëtar i Kryesisë së Kuvendit nga Koalicioni “Kthimi”

Heather Kashner, Drejtor i NDI-së në Kosovë.

Kam pasur një takim me anëtarin e kryesisë Z. Oliver Ivanovic, nga “Koalicioni Kthimi”, dhe liderin e grupit z. Dragisha Krstoviq në zyrën e tij gjatë një pauze të shkurtër mes seancës plenare të Kuvendit. Qëllimi i takimit tonë ishte që të diskutojmë për prapëtimet e bëra në Kuvend. Por, unë u mahnitua nga ndryshimet të cilat i vërejtja nga takimi im i parë me Ivanoviqin në Mitrovicë para dy vitesh. Sa kuptova unë, gjërat kanë ndryshuar për të mirë.

Dy vite më parë, Ivanoviq dhe komuniteti i tij nuk ishin pjesë e institucioneve qeverisëse të Kosovës dhe ai nuk e përkrahte një veprim të tillë. Gjatë asaj mbledhje, Ivanoviq u inkuadrua në një debat të fuqishëm me përfaqësuesin e OSBE-së përkitazi me rolet dhe përgjegjësitë e komunitetit ndërkombëtar në raport me liderët politik serb të Kosovës për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e serbëve në Kosovë, dhe për t'i plotësuar zbrazëtitirat në marrëdhëniet me shqiptarët e Kosovës. Të dy palët ishin të mendimit se pala tjetër se do të mund të bënte më tepër.

Sot, derisa po qëndronim së bashku në zyrën e tij në Prishtinë, pas seancës plenare të Kuvendit në të cilën morrën

pjesë të gjitha komunitetet e Kosovës dhe ku zhvilluan një shkëmbim të pikëpamjeve, me të filluar intervistën, e patëm të qartë se përkunder ndryshimit të disa gjërave, gjëra të tjera akoma ngelin të njëjta.

Çfarë përparimi është bërë prej se kur ka filluar të funksionoj Kuvendi?

Që nga fillimi ne ishim të brengosur për rolin tonë në Kuvend. Në këtë çast kemi një situatë pak a shumë të ngjashme me atë në fillim, edhe pse atmosfera midis anëtarëve të Kuvendit është stabilizuar dhe nuk është më aq e tensionuar sikur që ishte dikur. Ne kemi zhvilluar disa kontakte me komunitetet tjera. Megjithatë, nuk ka ndonjë përmirësim të raporteve midis grupeve parlamentare serbe dhe shqiptare. Ne nuk jemi të kënaqur me rolin tonë. Tani ne nuk mund të ndryshojmë asgjë. Ne nuk jemi vetëm një minoritet. Ne jemi më shumë se kjo. Ne jemi përfaqësues të një minoriteti etnik. Por, unë nuk e shoh rolin tonë si rol vendim marrës, apo rol i cili ndikon në vendim marrje. Ne nuk kemi ndikim në vendime dhe kjo na bën të ndjehemi shumë të frustruar.



Sipas mendimit tuaj a ekziston ndonjë legjislacion i cili ka pasur ndikim pozitiv në jetën e serbëve në Kosovë?

Çdo gjë këtu është e ndërlikuar me politikë. Ne druajmë që këto ligje janë duke bërë promovimin e një shteti të pavarur; ekziston një pikësynim i qartë: të promovohet pavarësia në njëfarë mënyre nëpërmjet projektligjeve. Ne kemi qenë shumë të interesuar për disa ligje. Kështu, ne votuam për ligjin mbi shkollimin fillor dhe të mesëm, megjithëse nuk ishte lehtë. Por ne vendosmërisht ishim kundër ligjit mbi shkollimin e lartë për arsye se ky ligj nuk legalizon universitetet

e grupeve tjera etnike në të njëjtën mënyrë si e legalizon Universitetin e Prishtinës. Për këtë arsye ne hasëm në një rezistencë të madhe nga shumica shqiptare në Kuvend, gjë e cila na bëri të mjaft të dyshimtë. Ne konsideruam kërkesën tonë, si një kërkesë që kishte të bënte kryekëput me arsimimin, por mua m'u dukë sikur kundër-agumenti i shqiptarëve ishte se kjo ishte një mënyrë e separatizmit. Kjo na brengos shumë lidhur me aktivitetet tona të ardhshme. Një tjetër ligj është projektligji mbi rregjistrimin e popullsisë për vitin e ardhshëm. Ky ligj plotësisht përjashton serbët PZHV (personat e zhvendosur brenda vendit) apo PZHV-të tjerë që gjenden jashtë Kosovës. Ne, me të vërtetë nuk mund të votojmë për një ligj të tillë. Prandaj, me vendosmëri do të jemi kundër tij, dhe njëkohësisht do t'i informojmë të gjitha organizatat ndërkombëtare në vend dhe jashtë vendit, prej të cilave do të përpiqemi të sigurojmë përkrahjen e plotë.

Cilat janë aktivitetet e “Koalicionit Kthimi” jashtë Kuvendit të cilat dëshmojnë se ju i përfaqësoni pikëpamjet e qytetarëve?

Ne përpiqemi të bisedojmë me qytetarët aq sa mundemi. Por ju e dini se liria e lëvizjes sonë është e kufizuar. Ne ende nuk e kemi lirinë e lëvizjes, gjë që na vështirëson zhvillimin e një aktiviteti të tillë. Komuniteti ynë brengoset për lirinë e lëvizjes, sigurinë dhe ekonominë.

A jeni në gjendje të takoheni me anëtarët serb të kuvendeve komunale në mënyrë që t'i përcaktoni nevojat e tyre?

Kjo nuk ngjan aq shpesh siç kam pritur. Sërisht, liria e lëvizjes është e kufizuar me këte edhe mundësitë. Ata gjithashtu janë të ngarkuar mjaft me përgjegjësitë e tyre. Ne duhet ta përmirësojmë këtë situatë.

Si e perceptojnë rolin tuaj në Kuvend?

Ne kalojmë shumë kohë me qytetarët duke u përpjekur t'i bindim ata se roli ynë në Kuvend është i vlefshëm. Disa prej tyre e kanë kuptuar këtë, por shumë qytetarë tjerë mendojnë se roli ynë është vetëm humbje kohe për shkak se ata nuk shohin rezultate. Natyrisht, ne e dimë se është me rëndësi për ne që të jemi pjesë e këtij procesi por në këto rrethana është mjaft vështirë ta



Prof. Gojko Saviq dhe z. Oliver Ivanović, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit nga Koalicioni Kthimi (KK), duke dalur nga ndërtesa e Kuvendit pas njëres nga mbledhjet plenare të së enjtes.

bindim një person të moshës mesatare për një gjë të këtillë.

Çfarë mendoni se mund të bëhet për ta përmirësuar këtë gjendje?

Gjëja e parë që mund të bëjmë është ta harrojmë të kaluarën. Unë nuk po them ta falim, por ta harrojmë. E kaluara, si e kaluara e largët ashtu edhe e kaluara e afërt, rikujtojnë ndjenja negative të dyja palëve. Dhe tani për tani ne nuk mund ta parashikojmë të ardhmen. Ne duhet të përqëndrohemi në çështjet aktuale, bie fjala, si mund t'i zgjidhim problemet metë

cilat ballafaqohemi të gjithë. Unë gjithashtu mendoj se PSSP-ja duhet të ndërmerr ca masa për të rritur ndikimin e minoriteteve etnike. Ne nuk jemi një minoritet i vogël, por ne vërtet nuk kemi ndikim në procesin e vendim marrjes.

Çfarë masa mund të ndërmerr PSSP-ja?

Afër mendsh, ne nuk presim veto. Kjo do të ishte jodemokratike, prandaj ne nuk e dëshirojmë një gjë të tillë. Por, sigurisht që duhet të ketë ndonjë mënyrë tjetër. Për shembull, ministrat nuk kanë zëvendës të tyre. Në- qoftëse do të kishim krijuar

pozita të zëvendësminist-rave me ca autoritet apo pushtet, kjo do të kishte përmirësuar situatën.

Intervistës filloi t'i afrohet fundi dhe unë vëreja që, derisa shumë gjëra kanë ndryshuar që nga takimi im i parë me Z. Oliver, çështja e njejtë u ndërlidh në bisedën tonë. A janë duke i përmbushur përgjegjësitë e tyre komuniteti ndërkombëtarë dhe liderët politik serb në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të serbëve në Kosovë dhe a janë duke i plotësuar zbrazëtitrat me shqiptarët e Kosovës? Me fjalë të tjera sipas Z. Oliver Ivanović, duhet të punohet më shumë.

Aktivitetet e fundit në mbështetje të Kuvendit të Kosovës

Promovimi i tolerancës

Që nga viti 1993, fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNSt) dhe Komiteti Amerikano Hebraik janë duke e organizuar një program të përbashkët të quajtur "Promovimi i tolerancës në Evropën Qendrore dhe Lindore." Deri më tash janë mbajtur 10 takime, që kanë pasur për qëllim ngritjen e vetëdijes politike dhe promovimin e tolerancës në rajon. Këtë vit pjesëmarrësit ishin nga Evropa qendrore, lindore dhe jugore. U mbajtën dy takime, i pari në Shkup, nga 10-13 prill 2003, ndërsa i dyti nga 30 maji deri më 2 qershor. Znj. Edita Tahiri, deputete e Kuvendit të Kosovës, mori pjesë në të dyja ngjarjet. Projekti do të përfundojë në tetor me organizimin e një udhëtimi studimor për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Konsultimet mbi situatën e minoriteteve

OSBE-ja është duke mbajtur takime me ministrat dhe komisionet përkatëse të Kuvendit të Kosovës për t'i inkurajuar institucionet që të njihen më për së afërmi me "Vlerësimin e dhjetë me radhë të gjendjes së minoriteteve etnike në Kosovë" të zhvilluar nga OSBE -ja dhe UNHCR-i. Me anë të këtyre vlerësimeve, OSBE-ja synon ta ngris vetëdijen mbi rekomandimet e saj mbi mënyrat e përmirësimit të situatës së komuniteteve minoritare në tërë Kosovën, dhe t'i inkurajojë ministrat dhe komisionet që t'i implementojnë strategjitë e dhëna. OSBE-ja tashmë është takuar me kryeministrin dhe me një numër të ministrave. Shpresohet se takimet me kryesuesit e komisioneve përkatëse do të mbahen gjatë muajit qershor. Vlerësimi i publikuar më 10 maj, ishte i dhjeti në radhën e vlerësimeve që kanë për qëllim përgatitjen e një vlerësimi objektiv të gjendjes së minoriteteve etnike në Kosovë. (shiko <http://www.osce.org/kosovo/democratization/>)

Drejt kontrollit parlamentar

Më 9 maj 2003, në Prishtinë u mbajt tryeze e parë e rumbullakët midis deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe të atij holandez, që u organizua nga Projekti i praktikave parlamentare Lindje-Perëndim. Në fokus të kësaj tryeze të rumbullakët, ishin marrëdhëniet brendapartiake dhe ndërpartiake. Z. Jan Dirk Blaauw, deputet i Parlamentit të Holandës dhe Kryetar i Asamblesë së Unionit të Evropës Perëndimore (WEU), zhvilloi një diskutim intenziv me deputetët e Kuvendit të Kosovës. Më poshtë janë dhënë konkluzionet dhe sugjerimet e tij.

Jan Dirk Blaauw, President of the WEU Assembly

I kam përcjellë rrjedhat në Kosovë që nga koha kur janë vërejtur shenjat e para të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, si pasojë e së cilës një numër jashtëzakonisht i madh njerëzish humbën jetën. Që nga miratimi i saj më 1999, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara vazhdon të jetë bazë për rindërtimin e Kosovës dhe për praninë e trupave ndërkombëtare civile dhe të sigurisë, gjë e cila ka mundësuar krijimin e një ambienti të sigurtë dhe një administratë të përkohshme për Kosovën. Ne fare mirë e dimë se kjo është vetëm një zgjidhje e përkohshme. Së këndejmi në këtë fazë tranzicioni, që është duke u mbikëqyrë nga institucionet ndërkombëtare - UNMIK-u, duhet bërë çmos që në Kosovë të ndërtohen dhe zhvillohen institucione të një vetëqeverisjeje demokratike dhe autonome, "për krijimin e kushteve për një jetë normale, dhe në paqë për të gjithë banorët e Kosovës", në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare.

Në mes tjerash, UNMIK-u ka për detyrë që t'ua transferoj përgjegjësitë administrative institucioneve të përkohshme

të vetëqeverisjes. Unë e di se ky nuk është proces i lehtë, pjesërisht për shkakun se këtyre institucioneve u mungon përvoja. Prandaj, qëllimi i tryezës së rumbullakët midis deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe të atij holandez, ka qënë këmbimi i përvojave nga lëmi i praktikave parlamentare, që janë me rëndësi themelore për kontrollin demokratik të politikës qeveritare.

Në kohën e ish-Jugosllavisë, e posaçërisht regjimit të Millosheviqit, shumica e njerëzve në Kosovë patën fatin e keq të jenë viktime të një mungese evidente të ligjshmërisë, kontrollit demokratik dhe mbështetjes publike të politikës qeveritare. Pothuaj tërësisht të privuar nga e drejta për të marrë pjesë në administrimin publik dhe në strukturat tjera vitale shoqërore dhe ekonomike në Kosovë, shqiptarët e Kosovës vendosën t'i formojnë strukturat paralele. Për arsye, të cilat në atë kohë ishin mjaft të kuptueshme, këtyre strukturave u mungonte transparenca dhe kontrolli demokratik që janë norma të shteteve të Evropës perëndimore. Këto struktura paralele financoheshin nga kontributet e shqiptarëve të Ko-

sovës të cilët jetonin në Kosovë dhe në diasporë, mirëpo, nuk ekzistonte ndonjë sistem transparent i llogaridhënies, kështu që shumica që jipnin të holla për këto struktura, nuk e dinin se si shpenzoheshin paratë e tyre.

Unë jam i vetëdijshëm se në rrethana të tilla nuk është lehtë që sa të hapësh e të mbyllësh sytë të krijohet ndonjë sistem efektiv i kontrollit parlamentar mbi politikën qeveritare. Një kontroll i tillë mund të realizohet vetëm në sja të përpjekjeve dhe përkushtimit të parlamentarëve, të dijës së tyre të thellë mbi sistemin institucional dhe shoqërinë dhe, e fundit nga radha, por jo edhe nga rëndësia, në sajë të përvojës së tyre.

Duke marrë parasysh faktin se Kosova ka përjetuar një krizë të thellë dhe një dhunë të tmerrshme, si pasojë e së cilës jo vetëm që u zhvendos gjysma e popullatës, por edhe u rrënuar i tërë sistemi institucional, mua më duket se do të nevojitet kohë që të krijohet një sistem efikas i kontrollit parlamentar, siç është ai i Holandës.

Shumica e partive politike janë formuar gjatë luftës për çlirim nga regjimi i Serbisë dhe menjëherë pas saj.



Duket se ideologjitë shoqërore dhe ekonomike në Kosovë ende konsiderohen më të parëndësishme se përçarjet në grupet etnike dhe në klanet e ndryshme. Si rrjedhojë, duket se numri i madh i ndasive dhe debateve që zhvillohen në Kuvendin e Kosovës më shumë dëshmojnë afinitetin për pushtet, sesa për mirëqenje të popullatës, për të ardhmen e Kosovës apo për zhvillimin e saj ekonomik. Marrëdhëniet brenda partiake gjithashtu bazohen në fuqinë e liderëve të partive politike dhe të rrethit të tyre, përderisa vërehet se ekziston një disiplinë hierarkike.

Pata kënaqësinë që të shoh përfaqësuesit e grupeve minoritare të marrin pjesë në këtë tryezë të rumbullakët. Njëri nga ata u ankua se shumë parti politike, përfshirë organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, nuk i kanë kushtuar mjaft rëndësi mendimeve të minoritetit të tij. E konsideroj sukses të veçantë të një shteti demokratik, kur në shoqërinë e tij minoritetet kanë të drejta të barabarta. Në një vend të mirëfilltë demokratik, pluralizmi politik është me rëndësi jetike dhe nëse një qeveri apo koalicion i partive

politike formon qeverinë pas një fitoreje në zgjedhje, kjo nuk do duhet ta ketë për rezultat mohimin apo injorimin e të drejtave të atyre që i kanë humbur zgjedhjet. Duhet të parandalohet atmosfera e tëhuajimit dhe e segregacionit politik në Kosovë.

Përfundimisht, jam i vetëdijshëm se UNMIK-u, BE-ja dhe insitucionet tjera të involvuara në administrimin e përkohshëm të Kosovës, gjatë tërë kësaj kohe kanë insistuar në "standardet para statusit." Bazuar në bisedat që i kam zhvilluar me krerët politikë të Kosovës, si dhe me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, dyshoj se standardet mund të përmbushen përderisa statusi i Kosovës do të vazhdojë të mbetet i paqartë. Çështja e statusit të pazgjidhur më shumë po e pengon zhvillimin ekonomik të Kosovës, po i largon investitorët dhe e po e detyron klasën politike të Kosovës të përdorë teknika manovruese lidhur me statusit e ardhshëm të provincës, se sa që po ndikon dhe ndihmon në ndërtimin e institucioneve të mirëfillta dhe të respektueshme, apo të ndonjë ekonomie produktive dhe të qëndrueshme. Statusi kuaja nuk mund të mbahet përgjithmonë, por çfarëdo debati lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës do të jetë i pakuptimtë, përderisa protagonistët kryesorë nuk përpiqen të hyjnë në një dialog serioz.

Qasje e lirë në dokumentet zyrtare

Kuvendi i Kosovës është duke e shqyrtuar një projektligj mbi qasjen në dokumentet zyrtare. Ligji në fjalë ka për model ligjet e ngjajshme që zbatohen në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky ligj është i rëndësishëm, sepse do t'i ndihmojë qeverisë që të jetë më transparente dhe të ketë përgjegjësi më të madhe ndaj qytetarëve të Kosovës.

David Toomey, Kosovo Consultant for the National Democratic Institute (NDI)

Njëri nga synimet kryesore në një shoqëri demokratike është të sigurohet që qeveria të ketë përgjegjësi ndaj popullit. Bazë e demokracisë është besimi që njerëzit kanë në qeverinë. Rreth 40 vjet më parë, kur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës po shqyrtohej një masë e tillë ligjore, senatori Russell Long nga Louisiana, tha se "qeveria jotransparente nuk është e dobishme për askënd.

Një Qeveri e tillë vetëm sa i dëmton njerëzit, në shërbim të të cilëve duhet të jetë; ajo njëherësh dëmton dhe çënon integritetin dhe funksionimin e saj, shkakton mosbesim, shuan entuziazmin e qytetarëve të saj dhe shpërfill besimin e tyre."

Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës janë përpjekur që ligjet t'i hartojnë në mënyrë të hapur dhe transparente. Qasja e lirë në aktin e dokumenteve zyrtare do ta mundësojë qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e një qeverie e cila do të jetë transparente e jo sekrete ndaj qytetarëve.

Ky ligj na bën të supozojmë se të gjithë qytetarët do të kenë qasje të lirë në të dhënat që i posedon Qeveria e Kosovës. Prandaj, ky ligj do t'ua mundësojë qytetarëve të Kosovës që të kenë qasje në ligjet, rregulloret dhe dokumentet të cilat lëshohen nga

Qeveria. Ligji parasheh që të gjitha të dhënat e qeverisë të jenë në dispozicion të publikut dhe njëherësh e ngarkon qeverinë që të dëshmojë se asnjë lloj informate nuk është mbajtur në fshehtësi. Disa përjashtime, kur nuk lejohet qasja në dokumente, mund të bëhen, nëse publikimi i të dhënave rrezikon sigurinë publike, cenon privatësinë e individëve dhe/ose interesat afariste të ndonjë personi. Megjithatë, këto përjashtime duhet të bëhen sa më rrallë që të jetë e mundur - qëllimi i këtij ligji është që të mundësojë qasje të lirë në të gjitha dokumentet zyrtare të Qeverisë, e jo ta ndalojë këtë qasje. Ligji mbi qasjen në dokumentet zyrtare do të jetë i vlefshëm, jo vetëm si mjet që siguron qasje në informata, por edhe si mjet i cili shërben për të verifikuar dhe provuar nëse qeveria është duke punuar në të mirë të qytetarëve. Publiku, përmes informacionit, në të cilin sipas këtij ligji do ketë qasje, mund ta mbikëqyrë punën e qeverisë dhe njëherësh do ketë mundësinë që të verifikojë nëse Qeveria vazhdon të jetë e përgjegjshme dhe e vetëdijshme për nevojat e qytetarëve. Përveç kësaj, ekzistimi i një akti të tillë mund ta motivojë Qeverinë që t'i kryejë obligimet e saj si

duhet, ngase qeveritarët do të jenë koshient se veprimet e tyre do të jenë vazhdimisht objekt i shqyrtimit publik. Komisioni i Shërbimeve Publike dhe Kuvendi i Kosovës e kanë kuptuar rëndësinë e kësaj çështjeje. Prandaj, Kuvendi tashmë e ka shqyrtuar njëherësh projektligjin. Me 6 qershor, Komisioni i Shërbimeve Publike mbajti një seancë publike mbi këtë projektligj, ku ftoi dëshmitarë nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Shërbimeve Publike, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare dhe përfaqësues të mediave.

Kjo ishte vetëm e treta seancë publike që Kuvendi e ka mbajtur pas themelimit. Është me rëndësi që një ligj, i cili qytetarëve u siguron qasje më të madhe në dokumentet zyrtare të qeverisë, të konsiderohet i denjë për seancë publike. Jo vetëm që ky ligj mund të shërbejë si

shembull i transparencës në Qeveri, por seanca publike gjithashtu dëshmon se Kuvendi funksionon më së miri nëse është transparent gjatë procesit të shqyrtimit të ligjeve.

Ligji mbi qasjen në dokumentet zyrtare është i dobishëm si për Qeverinë dhe Kuvendin, ashtu edhe për qytetarët e Kosovës. Ligjet e ngjashme që janë miratuar në vendet tjera demokratike ua kanë mundësuar atyre ta fitojnë besimin e qytetarëve, meqë duke u bazuar në këto ligje, ato vende kanë arritur të themelojnë institucione të hapura ndaj publikut, të ndershme sa u përket sjelljeve të zyrtarëve të tyre dhe transparente në zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Miratimi i këtij ligji do t'i ndihmojë si Qeverisë, ashtu edhe Kuvendit të Kosovës, për të siguruar besimin e qytetarëve të Kosovës.



Debat i organizuar nga FSNT për stafin ligjor

Me datë 30 maj të këtij viti ASI-it në bashkëpunim me OSBE-në, FSN-t organizoi një debat për stafin ligjor të Kuvendit. Tema e këtij debati ishte roli dhe rëndësia e Departamentit për Çështje Ligjore në Kuvendin e Kosovës. Z. Ronald Verner nga Bundestagu gjerman prezantoi shembuj konkret dhe njëherësh drejtoi një diskutim mjaft të gjallë dhe efikas lidhur me përmirësimin e aftësi administrative dhe të komunikimit të pjesëmarrësve, gjatë punës dhe përkrahjes të anëtarëve të komisioneve. Veç kësaj, u diskutua mbi rolin kreativ të stafit ligjor me rastin e ofrimit të këshillave ligjore deputetëve si dhe për mënyrat e nxitjes së interaksionit me përfaqësuesit e ministrave me rastin e përgatitjes së projekt ligjeve.

Konferenca e katërt Parlamentare e Paktit të Stabilitetit në Bruksel

David Buerstuedde, Zyra për Çështje Politike, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Më 21 dhe 22 maj parlamentarët nga mbarë Evropa u mbledhën në Bruksel për të diskutuar mbi politikën e re të Unionit Evropian (UE) për Evropën Juglindore (EJL). Pjesëmarrësit e Parlamentit Evropian, nikoqir i mbledhjes, OSBE-ja dhe Asambletë Parlamentare të Këshillit të Evropës morën pjesë në këtë ngjarje. Veç kësaj, parlamentarët e parlamenteve kombëtare të Italisë, Moldovës dhe Bosnjës dhe Hercegovinës përfaqësuan Inicativën Rajonale të Adriatikut dhe Detit Jon, Inicativën e Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit Ekonomik të vendeve të Detit të Zi dhe Procesin e Bashkëpunimit Juglindor, përkatësisht, strukturat më

relevante të bashkëpunimit në rajon. Njëherësh, përpos këtyre strukturave me rëndësi, në këtë eveniment morën pjesë edhe një numër i organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve anëtare të EJL.

Lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikimit të drogës, armëve dhe njerëzve, ishin disa prej temave kryesore që u shqyrtuan në konferencën e katërt parlamentare të Paktit të Stabilitetit. Përpos kësaj, mjaft kohë i është kushtuar shqyrtimit të rolit të shoqërisë civile në përforcimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit.

Megjithatë, diskutimi është përqëndruar kryekëput rreth pikësnyimeve strate-

gjike për të përshpejtuar asociimin e EJL-së në Union Evropian. Përkundër vështrësive të shumta, aty u shpreh një optimizëm sa i përket konsolidimit të mëtejshëm të demokracisë dhe zhvillimit ekonomik. Shtetet anëtare të EJL-së do të dëshironin që UE-ja të tregojnë edhe më tutje angazhimin e vet në rajon, duke ofruar kështu një perspektivë të qartë për anëtarësimin e këtyre vendeve dhe duke i zaxhruar programet me dëshmi të qarta për pranimin e kandidatëve të Evropës Qendrore dhe Lindore si anëtarë të shteteve të EJL-së.

Sa i takon Kosovës, Konferenca në përfundim, e ftoi Kuvendin e Kosovës të veprojë konform frymës pajtuese me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 dhe me Kornizën Kushtetuese. Aty u theksua se stabiliteti dhe prosperiteti i Kosovës ende varet nga respektimi i të drejtave të të gjithë qytetarëve dhe në veçanti nga kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur, si dhe nga mbrojtja e mirëfilltë e minoriteteve të Kosovës.

Anëtarët e Kuvendit të Kosovës nuk ishin të pranishëm gjatë konferencës sepse kjo ishte njëra nga tri konferencat ndërkombëtare në të cilën pjesëmarrja e IPV-ve u anulua nga PSSP-ja pas miratimit të të ashtuquajturës rezoluta mbi "vlerat e luftës". Megjithatë, tanimë dihet se ata do të ftohen për të marrë pjesë në Konferencën e ardhshme parlamentare të Paktit të Stabilitetit e cila do të mbahet në vjeshtë të vitit 2003.

Konferencat parlamentare të Paktit të Stabilitetit janë shndërruar në ngjarje të rregullta të stabilizimit të procesit për EJL-në që nga konferenca e parë që u mbajt në shtator të vitit 2001. Ata u ofrojnë parlamentarëve nga mbarë Evropa një platformë në të cilën këmbëhen pikëpamjet dhe vlerësohet situata aktuale në rajon e çështjeve të demokracisë, të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit si dhe zhvillimit shoqëror-ekonomik. Përfundimet të cilat arrihen në një konferencë të këtillë shpesh herë marrin formën e rekomandimeve për shtetet në rajon dhe për faktorët ndërkombëtarë të përfshirë në EJL.



Vizitë e frytshme pune në Shqipëri

Prej datës 12 deri me 15 maj 2003, anëtarët e tri komisioneve parlamentare të Kuvendit të Kosovës vizituan Tiranën, për të takuar kolegët e tyre nga Kuvendi i Shqipërisë. Ne vijim është raporti, i shkruar nga znj. Fetije Kepuska, anëtare e Kuvendit nga radhët e LDK-së, dhe z. Uli Steinle, nga fondacioni Friedrich Ebert Stiftung.

Fetije Kepuska dhe Uli Steinle

Me qëllim të vendosjes dhe përforcimit të bashkëpunimit të ndërsjellë me Parlamentet tjera europiane, në veçanti me ato të Europës Juglindore, një delegacion i Kuvendit të Kosovës vizitoi Tiranën më 12-15 maj 2003. Delegacioni përbëhej nga kryesuesit dhe anëtarët e tri komisioneve parlamentare: Komisionit për Shëndetësi, Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe Komisionit për Ambient dhe Planifikim Hapësinor. Kjo vizitë u organizua nga Fondacioni 'Friedrich Ebert'. Delegacioni pati rastin të njihet më për së afërmi me punën parlamentare dhe të krahasojë të arriturat, rezultatet, vështësitë dhe problemet. Gjatë takimit me homologët tanë nga Shqipëria, delegacioni ynë diskutoi mbi mënyrën e funksionimit të komisioneve të sipërpërmendura, me theks të veçantë në procesin e miratimit të ligjeve. Njëherësh janë mbajtur edhe takimet me kryesuesit dhe me anëtarët e stafit të komisioneve të lartëpërmendura për të diskutuar rreth planeve të punës së Komisionit, si dhe për çështjet më të rëndësishme politike të tranzicionit. Me interes të veçantë,

ishte mundësia dhe rasti që të merrnim pjesë aktivisht në sesionet e komisioneve dhe që të vëzhgonim seancën publike të drejtuar nga Komisioni Parlamentar për Shëndetësi. Debati profesional dhe mjaft kontraverz i ekspertëve mbi procesin e privatizimit në sektorin e shëndetësisë, është parë dhe është konsideruar si mjet i rëndësishëm në diskutimet parlamentare të draft ligjeve. Nuk është për t'u çuditur që diskutimi i draft ligjeve në nivelin e komisioneve nganjëherë zgjatë edhe me muaj të tërë, vetëm e vetëm për hir të kontrollimit, përmirësimit dhe përgatitjes sa më të mirë të draftit origjinal të ligjit, i cili do të kishte implikime më të gjera shoqërore.

Në takimet me Kryetarin e Parlamentit z. Servet Pëllumbin, Ministrin për Ambient, Prof. Dr. Lufter Xhuvelin, dhe Ministrin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, znj. Valentina Leskaj, u diskutua rreth sfidave politike për implementimin e standardeve evropiane. Përmirësimi i strukturave politike dhe administrative, si dhe i punëve rutinore është parë si një proces i vazhdueshëm, i cili ka për qëllim zgjidhjen sa më adekuate



Gjatë periudhës kohore 12 - 15 maj 2003, një delegacion multipartiak dhe multietnik i Kuvendit të Kosovës, vizitoi Tiranën për të takuar kolegët e tyre nga Kuvendi i Shqipërisë.

dhe sa më të shpejtë të problemeve të tranzicionit ekonomik dhe social pas periudhës komuniste. Veç kësaj, është theksuar edhe nevoja për ndihmë ndërkombëtare dhe për një bashkëpunim produktiv me organizatat joqeveritare në sfera të caktuara politike, si dhe janë këmbyer përvoja të ndryshme.

Foashtu, janë identifikuar dhe diskutuar problemet më të shpeshta dhe më të rëndësishme në fushat përkatëse, si: lufta kundër papunësisë, problemet serioze të ambientit posaqërisht në zonat dhe rajonet e industrializuara dhe reforma dhe përmirësimi i sektorit shëndetësor nën ku-

shtet e vështira financiare. Kështu të dyja palët ranë dakord që ta vazhdojnë dialogu dhe këmbimin e përvojave veçanërisht në këto fusha, ku kanë ekzistuar kushte dhe ku janë shfaqur probleme të ngjajshme organizative.

Kjo vizitë u vlerësua unanimisht nga të gjithë anëtarët e delegacionit si shumë e mirëseardhur dhe e dobishme. Ishte veçanërisht interesante të shohësh se sa janë të ngjajshme kushtet e punës parlamentare dhe sa shumë mund të mësohet dhe përfitohet nga një dialog i intensifikuar rajonal mbi problemet e përbashkëta, të cilat nganjëherë vështirë se mund të krahasohen me

situatën dhe me problemet në vendet e Evropës Perëndimore, siç është rasti p.sh me shkallën e lartë të papunësisë.

Gjatë kësaj vizite, janë identifikuar sfidat dhe problemet e përbashkëta, janë këmbyer përvojat dhe strategjitë si dhe janë realizuar kontakte me qëllim të vazhimit të dialogut në nivel komisionesh. Këto vizita në vende të ndryshme të rajonit dhe në vende të tjera evropiane, do të kontribuojnë shumë në njohjen më të mirë ndërmjet tyre dhe në këmbimin e përvojave që do t'u mundësojë komisioneve dhe Kuvendit të jenë më efikas dhe më të suksesshëm.

Qytetarët vëzhgojnë: Monitorimi i Kuvendit të Kosovës.

Pas monitorimit të tri proceseve zqjedhore në Kosovë, KMDLNJ në bashkëpunim me OSBE-në dhe e trajnuar nga NDI është duke implementuar projektin "Qytetarët Vëzhgojnë" për monitorimin e punës së 11 kuvendëve komunale dhe të Kuvendit të Kosovës.

Ibrahim Makolli

Që nga prilli i vitit 2003, KMDLNJ ka akredituar vëzhguesit e trajnuar nga NDI për të monitoruar punën e Kuvendit të Kosovës, sesioneve plenare si dhe punën e 10 komisioneve parlamentare¹ Monitorimi i punës së Kuvendit të Kosovës nga ana e KMDLNJ-së ka për qëllim që të vëzhgojë respektimin e kornizës ligjore dhe procedurave ekzistuese nga ana e Kuvendit si dhe të promovojë dhe mbështesin çështjet të cilat konsiderohen si brenga të qytetarëve të Kosovës.

Duke u bazuar në vëzhgimin e vazhdueshëm, KMDLNJ në përgjithësi ka vlerësuar se puna e zyrtarëve dhe organeve të Kuvendit ka shënuar një përmirësim të dukshëm në respektimin e procedurave në fuqi.

Vëzhguesit e KMDLNJ-së raportojnë se janë duke u pritur shumë mirë nga ana e zyrtarëve të Kuvendit dhe se ata janë konstruktiv dhe të hapur ndaj vëzhguesve dhe perpjekjeve dhe angazhimeve për monitorim të KMDLNJ-së në përgjithësi.

Në këtë raport të shkurtër jemi përqendruar kryesisht në parregullësitë, shkeljet e procedurave dhe dështimet e tjera të zyrtarëve të Kuvendit, që janë shfaqur gjatë periudhës monitoruese shkurt - maj 2003.

Në përgjithësi, vëzhguesit e KMDLNJ-së kanë raportuar për atmosferë, kryesisht tolerante gjatë diskutimeve si në Kuvend ashtu edhe në komisionet parlamentare. Nuk është hetuar asnjë rast i diskriminimit në baza etnike qoftë në mbledhjet e Kuvendit, qoftë në mbledhjet e komisioneve. Të gjitha grupet etnike të përfaqësuara në Kuvend janë të përfaqësuara edhe nëpër komisionet parlamentare të Kuvendit.

Deputetët e koalicionit "Kthimi", kanë bojkotuar mbledhjet e Kuvendit dhe të komisioneve të tij për rreth 2 muaj me radhë, me ankesën se kryetari i Kuvendit po bën diskriminimin e tyre si dhe po mbivotohen në Kuvend. Deputetët e këtij koalicioni kanë pranuar të kthehen në Kuvend pas arritjes së marrëveshjes me Qeverinë e Serbisë dhe me kryeadministratorin e Kosovës për praninë e vëzhguesit ndërkombëtar të OSBE-së në mbledhjet e Kuvendit dhe të Kryesisë.

Edhe pas kthimit të tyre në Kuvend, deputetët e këtij koalicioni, në shenjë

¹ KMDLNJ monitoron punën e këtyre komisioneve parlamentare, të : Arsimi, Shkencës dhe Teknologjisë, të Punës dhe Mirëqenies Sociale, të Çështjeve Juridike dhe Kornizës Kushtetuese; të Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor; Barazisë Gjinore; të Shërbimeve Publike; të Financave dhe Ekonomisë, për Persona të Zhdukur; të Drejta Minoritetesh; Buxhet.

mospajtimi për disa nga çështjet e parashtuara, disa herë kanë braktisur seancat e Kuvendit. Për shembull, deputetët e koalicionit "Kthimi" kanë braktisur mbledhjen e Kuvendit, të datës 27 shkurt 2003, kur deputeti i PDK-së kërkoi që në rend të ditës si çështje urgjente të futet çështja Limaj, bazuar në rregulloren 25 të Rregullores së Procedurës.

Vëzhguesit kanë raportuar për vonesa në përgatitjen e materialeve, përkthimin dhe shpërndarjen e tyre anëtarëve të komisioneve. Në shumicën e rasteve, kryesuesit e komisioneve dorëzojnë materialet e përgatitura vetëm në gjuhët e tyre. Vëzhguesit e KMDLNJ-së kanë raportuar që komisionet parlamentare mbajnë mbledhjet e veta në mënyrë të rregulltë, përveç Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji i cili nuk mban mbledhjet e rregullta dy-javore duke shkelur kështu Rregulloren e Procedurës (Rregulla 40, Pika 9). Anëtarët e këtij Komisioni mosmbajtjen e mbledhjeve të rregullta e arsyetojnë me mungesën e çështjeve për diskutim.

Vëzhguesit e KMDLNJ-së gjatë punës së tyre kanë hetuar edhe shkelje të Rregullores së Punës, Rregulla 26, Pika 2, nga ana e kryetarit të Kuvendit, në rastet kur ai vendos vetë për pikat e reja të rendit të ditës dhe për shqyrtimin e ndonjë çështjeje tjetër, pa i hedhur paraprakisht ato në votim. Kryesuesi i Kuvendit gjithashtu bën shkelje të Rregullës 18 Pika 3. g) me rastin kur deputetëve ua mohon të drejtën për të debatuar me arsyetimin se duhet të "ruhet uniteti politik dhe veprues brenda Kuvendit". Shembuj tjerë janë hedhja në votim për futjen në rend të ditës të Rezolutës se propozuar nga GP i AAK-së, për njohjen e vlerave të luftës së UÇK-së; dhe ai kur deputetët patën mundësi që të votojnë për shkak të vonesës për t'i parashtuar pyetjet Kryeministrit të Kosovës, edhe pse një gjë e tillë ishte paraparë me rend të ditës.

Duke u bazuar në debatet nga seancat plenare, KMDLNJ fiton përshtypjen që anëtarët e Kuvendit nuk janë të përgatitur për diskutime përmbajtësore dhe të mirëfillëta të pikave të rendit të ditës, gjë që zakonisht rezulton në fjalime të stërngarkuara me fraza dhe emocione në vend të analizave. KMDLNJ ka vërejtur edhe pasiguri të deputetëve gjatë votimit të projektligjeve të ndryshme.

Brenga kryesore e KMDLNJ-së mbetet votimi sipas kutit partiak apo etnik, si në sesionet plenare ashtu edhe në ato të komisioneve.

KMDLNJ vlerëson që Presidenti i Kosovës ka shkelur Kornizën Kushtetuese , sipas së cilës Presidenti i Kosovës duhet t'i drejtohet Asamblesë së

Kosovës së paku një herë në vit dhe të raportoje mbi situatën e përgjithshme në Kosovë.

KMDLNJ shprehë shqetësimet e veta edhe përkthimi me vonesën e administratës së UNMIK-ut, konkretisht të kryeadministratorit në zvarritjen e nënshkrimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi, me çka edhe zvogëlon efektshmërinë e punës së Kuvendit dhe shkakton pakënaqësi.

Duke u bazuar në vëzhgimin dhe vlerësimet e veta, KMLDNJ rekomandon që:

- Kryetari i Kuvendit të jetë më konstruktiv në udhëheqjen e mbledhjeve dhe të respektojë procedurat për udhëheqjen e mbledhjeve
- Komisionet parlamentare të ftajnë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe institucione të specializuara gjatë shqyrtimit të çështjeve të ndryshme sidomos profesionale, në pajtim me Rregullën 40, Pika 3.;
- Komisionet të përpilojnë orarë të saktë të takimeve të tyre dhe me këtë të njoftohet opinioni për të mundësuar pjesëmarrjen e të interesuarve në mbledhje. Materialet të dorëzohen dhe të përkthehen me kohë në gjuhët e deputetëve për t'u mundësuar atyre pjesëmarrje aktive në shqyrtimin e çështjeve për diskutim;
- OSBE dhe organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare të sigurojnë trajnime për anëtarët e Kuvendit e posaçërisht të anëtarëve të komisioneve, dhe ne veqanti për t'ju përgjigjur interesave publike duke i integruar këto çështje në diskutim,
- Anëtarët e Kuvendit si dhe partitë politike të Kosovës të fillojnë përfaqësimin e qytetarëve dhe të marrin parasysh qëndrimet e tyre në lidhje me çështje të caktuara para marrjes së vendimeve dhe votimit, një proces që akoma ka ngjatur;
- Deputetët serbë duhet të sillen si deputetë të Kuvendit të Kosovës, të ndërprejnë praktikën e braktisjes së seancave të Kuvendit dhe të jenë më konstruktivë në përfaqësimin e interesave të popullatës që përfaqësojnë e jo, si deri më tash, të fitohet përshtypja se janë të dirigjuar nga politika zyrtare e Beogradit;
- Presidenti i Kosovës në afatin sa më të shkurtër kohor të paraqesë raport për gjendjen e përgjithshme në Kosovë, të paraparë me Kornizën Kushtetuese;

- Kryeadministratori i Kosovës të përshpejtojë nënshkrimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi në mënyrë që sa më shpejtë të kompletohet infrastruktura ligjore

The full report on monitoring the Assembly of Kosovo and 11 Municipal Assemblies can be found at: www.cdhrf.org



Prof. Dr. Fajazit Nushi, kryetar i KLMDNJ-së (në mes)
Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv i KLMDNJ-së (në të majtë)
Ibrahim Makolli, koordinator në KLMDNJ (në të djathtë)

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNJ)

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prishtinë është themeluar në dhjetor të vitit 1989 me qëllim që të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe liritë e njeriut, që burojnë nga Deklarata Universale e OKB-së për të drejtat e njeriut dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. KMDLNJ është e përkushtuar në mbrojtjen dhe në promovimin e të drejtave njerëzore dhe ndërtimin e një shoqërie demokratike në Kosovë.

KMDLNJ merret me hulumtimin dhe dëshmimin e shkeljes së të drejtave të njerëzore dhe kërkon nga të gjithë ata që ushtrojnë pushtet që t'i japin fund praktikave abuzive, dhe që të respektojnë ligjin e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

KMDLNJ është anëtare e Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (FIDH) dhe anëtare e Komitetit Drejtues të Ballkans Human Rights Network (BHRN). KMDLNJ ka 30 zyra në territorin e Kosovës (në çdo njësi komunale) me anëtarësi prej të gjitha grupeve etnike në Kosovë.

Hapat e parë të përbashkët

Përkrahja e krijimit të funksionimit të Kuvendeve Komonale

Kur ju besohet ndonjë detyrë, ju filloni me përgatitje intensive, duke marrë parasysh faktin se çfarë detyre me përgjegjësi do të kryeni. Kur të bëheni elektrikist, ju filloni me përgatitje intensive, duke marrë parasysh se çfarë detyre me përgjegjësi do të kryeni. Kur të bëheni anëtar i zgjedhur i Kuvendit Komunal, ju filloni të merrni vendime strategjike për të mirën e bashkëqytetarëve tuaj.

Hartmut Pürner, Ekipi për Përkrahje të Kuvendit Komunal, Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së

Një fenomen i çuditshëm ka ndodhur në Kosovë mes viteve 2000 dhe 2002. Nën-punësit civil iu janë nënshtruar një trajnimi gjith-përfshirës, kryesisht i organizuar nga Instituti për Administratë Civile i OSBE-së, në të cilin u trajnuan rreth 5200 persona. Më vonë është supozuar se, anëtarët e Kuvendit Komunal, pasi të zgjedhen do ta dijnë menjëherë se çfarë duhet të bëjnë.

Kosova ende nuk ka arritur në nivelin e zhvillimit demokratik me sistem të funksionimit të vet qeverisjes lokale dhe nuk ka ndonjë sistem të krijuar për trajnimin e kuadrove. Shpesh herë ishin të dukshme pasojat e seancave të stërzgjatura dhe kaotike të kuvendit pa rezultate konkrete.

Janë ofruar sesione sporadike trajnuese nga një numër i madh i fondacioneve ndërkombëtare, OJQ-ve dhe organizatave qeveritare, por nuk është ofruar ndonjë trajnim sistematik, afatgjatë dhe i disajnuar mirë mbi kornizën ligjore të Kosovës. Asnjë sistem i atillë nuk ka ekzistuar në Kosovë, përveçsisht nga nevojat shumë të madhe e cila është rezultat i mungesës së traditës demo-

kratike mbi vetqeverisjen lokale në Kosovë.

Duke filluar në nëntor të vitit 2002, ekipi për përkrahjen e Kuvendit Komunal në kuadër të Departamentit të Demokratizimit të OSBE-së, ka filluar të shqyrtojë këto nevoja. "Pakoja e masave për iniciimin e aktiviteteve të Kuvendeve Komonale", e përbërë prej pesë seksioneve, është paraparë që të ofrojë udhëzime gjatë gjashtë muajve të parë të mandatit të ri. Temat e diskutuara ishin: sesioni i parë i Kuvendit Komunal, të qenit anëtar i Kuvendit Komunal - rregullat elementare; si të zhvillohet mbledhja efektive; roli i opozitës; dhe puna e partive politike në Kuvendin Komunal.

Trajnimet e ofruar nga OSBE-ja janë udhëhequr nga trajnerët e Kosovës për kosovarët, në gjuhën e tyre amtare. Në këtë mënyrë trajnimi është pranuar më mirë dhe ka qenë më efektiv meqë është zhvilluar drejtpërdrejt në gjuhën shqipe, serbe dhe turke. Si përjashtim nga rregullat, dy kolegë nga Kombet e Bashkuara dhe Estonia i kanë përkrahur 18 trajnerët e OSBE-së. Kjo bëri të mundur dialogun dhe



"Politikat e komunave s'duhet të paraqesin ndonjë çështje serioze - një pamje nga trajnimi mbi pakon e masave për iniciimin e aktiviteteve të Kuvendeve Komonale në Prizren" (PMIAKK)

trajnimin e mëtejshëm, dhe një zbatim të shpejtë të tyre në të gjitha kuvendet e Kosovës ku rrethi politik mundësoi aktivitete të këtu. Si një efekt pozitiv, pjesëtarët "lokal" të personelit tonë morrën funksionin e ekspertëve të rinj të cilët do të vazhdojnë të punojnë në Kosovë dhe për Kosovën pasi që kolegët e tyre ndërkombëtarë të largohen prej Kosovës.

Çdo seksion i programit të pakos së masave për iniciimin e aktiviteteve të kuvendeve

Komonale fillon me sesionin "trajnimi i trajnerëve" i cili zhvillohet nga Niels Jermiin Nielsen, ish mësues në shkollën e famshme të Danimarkës, momentalisht i punësuar pranë OSBE-së. Meqë tash u është dhënë leja, trajnerët do t'i mbajnë sesionet tjera në çdo komunë. Që nga fillimi i qershorit, 120 sesione trajnuese janë zhvilluar në tridhjetë komuna. Gjithsej 1800 persona morën pjesë, me një pjesëmarrje mesatare me nga 15 anëtarë të Kuvendit Komu-

nal për çdo sesion. Në të shumtën e rasteve në seminare u zhvilluan diskutime dinamike mbi disa nga çështjet më të rëndësishme të jetës politike të Kosovës - ndarja e kompetencave, përfshirja e qytetarëve, mospërfillja e procedurave, marrëdhëniet e tensionuara midis palëve qeverisëse dhe atyre të opozitës dhe mungesa e demokracisë së brendshme në pothuajse të gjitha partitë politike.

Edhe më me rëndësi është fakti se trajnimet e pakos së masave për iniciimin e

aktiviteteve të kuvendeve komunale duket se kanë sjellur një ndryshim në kuvendet komunale të Kosovës. Procesi i zgjedhjes së kryetarëve, zëvendëskryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve në përgjithësi është zhvilluar në mënyrë shumë më të qetë se në vitin 2000. Në disa vende udhëheqja e mbledhjeve dhe diciplina në kuvende është përmirësuar dukshëm. Në lokacionet tjetra, votimi është bërë në mënyrë më pak kaotike. Ka pasur më shumë paraqitje me shkrim, të cilat ofrojnë përfshirje më të lehtë në procedura. Në Shtërpce është ndërruar interieri i Kuvendit me qëllim që të ofrojë dialog më të mirë. Anëtarët e Kuvendit Komunal kanë reaguuar ndaj parregullësive procedurale thjesht duke hedhur poshtë rregulloret relevante. Anëtarët e Kuvendit më shpesh insistojnë për njoftimet me kohë dhe dispozita të plota të materialeve të nevojshme. Janë duke iu përmbytur më mirë të ditës. OSBE-ja, me përkrahjen e anëtarëve tjerë të iniciativës për përkrahje të Kuvendit Komunal, veçanërisht me përkrahjen e Fondacionit Friedrich Naumann, do të vazhdojë me një programe të ri, duke filluar në qershor, të ashtuquajturin "Programi për përkrahjen e Kuvendit Komunal". Hapat e parë janë ndërmarrë bashkërisht. Kurse ka edhe shumë hapa të tjerë që duhet të ndërmerrin.

Studentë të Shkencave Politike përcjellin punimet e Kuvendit të Kosovës

Një nisim e OSBE-së, Departamentit të Demokratizimit/Iniciativa për përkrahje të Kuvendit në koordinim me Sekretariatit e Shërbimeve të Kuvendit, u ka bërë të mundur studentëve të Universitetit të Prishtinës përcjelljen e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Kosovës. Një numër i konsiderueshëm studentësh i Departamentit të Shkencave Politike dhe Administratës Publike tashmë kanë përfutur nga ky projekt

Sadri ABAZI, Student i vitit të dytë në Shkencat Politike/Administratë Publike

Ka një nevojë imanente në të gjithë këtë proces të zhvillimit apo konsolidimit të institucioneve vendore në Kosovë, për të vënë një bazë të qëndrueshme profesionale, si një parakusht thelbësor i shtytjes edhe më përpara të procesit për sublimimin e një sistemi të vetëqëndrueshëm politik, juridik e ekonomik, të mbështetur mbi parime të zhvillimit profesional dhe praktik. Mirëqenia e një vendi dhe populli, sikur që thotë Dr. Martin Luther (1483-1546), nuk varet aq nga pasuria e tyre, nga qëndrueshmëria e qyteteve të tyre, as nga bukuria e qyteteve; pasuria e një vendi përbëhet nga numri i njerëzve të arsimuar dhe njerëzve nga dituria dhe karakteri. (Burimi: Dillenberger, John. Martin Luther: E zgjedhur nga shkrimet e tij. Garden City: Doubleday, 1961).

"Sa ka dallime ndërmjet teorisë dhe praktikës! Sa janë prej atyre të cilët i kuptojnë gjërat mirëfilli, e nuk iu kujtohen ose nuk dinë të njëjtat të jetësojnë", thotë Francesko Guicciardini, filozof i njohur italian.

Në vijë me këtë që u tha, - ose më saktësisht për të pasur numër sa më të madh

njerëzish të stërvitur mirë dhe që dinë të jetësojnë gjërat në praktikë - mund të kuptohet edhe nisma e OSBE-së, Departamentit të Demokratizimit/Iniciativa për përkrahje të Kuvendit në koordinim me Sekretariatit e Shërbimeve të Kuvendit dhe Departamentit të Shkencave Politike, për t'u mundësuar studentëve të Universitetit të Prishtinës përcjelljen e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Kosovës dhe për të dëgjuar informacione të vlefshme dhe praktike nga zyrtarë të Kuvendit.

Projekti ka nisur që nga prilli i këtij viti dhe bënë të mundur që nga 20 studentë për çdo javë të mund të ndjekin nga afër punimet e Kuvendit të Kosovës. Një

numër i konsiderueshëm studentësh i Departamentit të Shkencave Politike dhe Administratës Publike tashmë kanë përfutur nga ky projekt.

Në këtë mënyrë ata do të kenë një mundësi të përshatshme që të gjitha mësimet e bëra teorike nga kurset si: Modelet e Demokracisë, Parlamentarizmi, Hyrje në Administratën Publike, Hyrje në Politikën Krahësuese, Hyrje në Shkencat Politike etj. të avancojnë edhe më tepër përmes mësimave praktikë.

Studentët, një orë para fillimit të seancës plenare do të marrin udhëzime mbi funksionin e Kuvendit dhe punën e tij. Udhëzimet jepen nga

z. Sali Rexhepi, kryesues i sektorit plenar dhe procedural dhe nga z. Sherif Konjufca, kryesues i sektorit për media. Pas këtij trajnimi për mënyrën se si punon dhe funksionon Kuvendi, studentët ftohen të përcjellin mbledhjen plenare. Kjo bëhet me qëllim përfshirjeje të Kuvendit të Kosovës në edukimin qytetar duke lejuar popullin e Kosovës të mësojë se si zhvillohen proceset demokratike në strukturat më të larta përfaqësuese dhe legjislative të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës.

Thjeshtë, përdorimi i teknikave praktike mësimore, do të jetë një hap i çmueshëm dhe konkret për lartësimin e proceseve demokratike.



Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinatore e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përparimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjyhësisë në Kuvend.

Si një koordinatore në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për kërret e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përkthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut - KMDLNJ, Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikën Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërpametar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



ASI
Newsletter

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188

kontakt: franklin.de-vrieze@omik.org

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetëm atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t